



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-2081/25
Kaçanik, 22.01.2025

FTESE PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e I (parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 31 janar 2025 (e premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e I (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 31.01.2025 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XII (dymbëdhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës e datës 24.12.2024;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I (parë) e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës për vitin 2025 e datës 15.01.2025;
3. Plani i punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025;
4. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSB, për vitin 2024;
5. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/-31319/24
Kaçanik, 24.12.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XII (dymbëdhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 24.12.2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës ishin 27 anëtarë-të gjithë.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Bejtulla Dalloshi, Maviye Murseli, Makfire Malsiu.

Në këtë mbledhje mori pjesë, Recep Gündüz - Koordinator i Qendrës Kulturore, Kosova në Bursa të Turqisë.

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe drejtori i SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, Shefki Guri.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, Fillimisht kërkoj të ngriheni në këmbë për një (1) minutë Heshtje, në shenjë nderimi dhe respekti për ish anëtarin e Kuvendit të Komunës, Rami Çaka, i cili ka ndërruar jetë para disa ditëve. Pasi u mbajt një minutë heshtje kryesuesi theksoj se për vdekjen e tij, e kam marrë lajmin me vonë.

E fillojmë mbledhjen e fundit për vitin 2024, fillimisht iu uroj festat e fund vitit, shëndet e mbarësi e suksese në vitin 2025, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, e hapi mbledhjen e XII (dymbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 24.12.2024, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut;
3. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;

4. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë;
5. Propozim Vendimi për Aprovimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;
6. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit.;
7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte).
8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “NTP GREN PRODUCT”;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “XHEMILE VISHI.B.I”;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 14 pikave.

1. Arovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbalin i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 27. Në sajë të kësaj del konstatimi së kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalit nga mbledhja e XI (njëmbëdhjetë) e Rregullt e KK, të datës 29.11.2024 / Lënda: 01Nr.060/01-29425/24.

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Ardita Rrahmani: Falënderoj z. Rexhep (Recep Gündüz) që ka gjetur kohë dhe na ka nderuar me qenë sot me ne.

Pyetjet: 1.Jemi në mbledhjen e fundit të këtij viti kalendarik, ajo që mbetet shqetësim, se po e mbyllim edhe këtë vit pa PZHK. E kam të paqartë sesi është e mundur që niveli lokal dhe ai qendror të rrinë indiferent ndaj një situatë me gjasë të paprecedent. A me tregon kush sesi do të arsyetohet niveli lokal dhe ai qendror para qytetarëve të këtij vendi që ia kanë dhënë besim absolut në nivel lokal dhe në përfaqësim absolut në nivel qendror. Është e pabesueshme të qëndrohet me kaq indiferencë kundrejt banorëve dhe kërkesave të tyre, e aq me pak kundrejt

shifrave, që për mua personalisht janë absolutisht alarmante për komunën tonë, ngase qytetarët po ikin. Këtë e thotë edhe regjistrimi i fundit i popullsisë. Ju të nderuar pushtetarë komunal, e ju që fjalën do të ua përcjellin ende pa dal nga kjo seancë, kujt dhe interesave të kujt po i shërbeni, sepse veç qytetarëve jo?

2. Përse dekorimi i sheshit, pavarësisht shijeve, po ndodhë në 10 ditët e fundit të vitit, pasur parasysh se gjithë dhjetori është festë? Kjo dihet që nga janari se kur janë festat e fund vitit. A jeni të informuar sesa vonë jeni këndellur për me i dhënë shpirt e atmosferë festive fëmijëve të këtij vendi? Në anën tjetër, duke ditur edhe shumën e kërkuar për qira të shtëpizave dhe kohën për sa janë dhënë në shfrytëzim, shto këtu edhe motin e ligë këto ditë, e që pak mund të shfrytëzohen, a keni menduar si do t'i stimuloni bizneset lokale, për të qenë pjesë e atyre shtëpizave edhe vitin tjetër? Për shqetësimet e mia, uroj të reflektoj kushdo që e ndien vetën përgjegjës. Gjatë studimeve njëri nga profesorët e mi të universitetit, ndau me ne këtë shprehje: “Ajo që bëhet gjithmonë para një vendimi, është konsultimi”. Politika me e mirë publike, bëhet kur dëgjoni ata që prekën prej saj, e jo me i thirrur pasi të vendosë politika.

z. Burim Shehu: E përshëndes valluan tonë Rexhep (Recep Gündüz) nga Turqia.

E kam një pyetje për kryetarin dhe drejtorin e urbanizmit: Rruga të shtëpia muze “Ismail Raka” e keni premtuar që 15 vjet, ndërkaq ende nuk është bërë asgjë. Lerë më që nuk është bërë rruga, por Shtëpia të cilën e keni meremetuar, është kthyer në gjendjen fillestare, është dobësuar, se puna nuk është bërë mirë. A keni ndërmend të me bërë diçka për këtë rrugë? Edhe sa do t'i premtoni asaj familje edhe qytetarëve për atë rrugën e njëjtë që e keni premtuar që 15 vite, apo do të vazhdoni me të njëjtin avaz duke rrejtur familjen dhe qytetarët?

z. Naim Beça: Përshëndes z. Rexhep (Recep Gündüz). Kam disa pyetje., do t'i përmbledhë të gjitha përnjëherë. Viti 2024 është vit i mossuksesit dhe gënjeshtreve që ia kemi bërë këtij populli e asnjë nuk e kemi plotësuar. Ky vit të jetë vit i harresës, ndërkaq viti 2025 të jetë vit i shpresës për të gjithë këtu që jeni. Shumë premtime i kemi thënë këtij populli, rrugë, aktivitete, premtime këto të cilat asnjë nuk e kemi realizuar. Ky vit ka qenë si vit pandemi, rrugë të papastra, kanalizimet në gjendje jo të mirë, salla e KK nuk u rregullua. Viti 2025 uroj të jetë vit ku do të kemi PZHK, rrugë të pastra, ujë të mjaftueshëm se kemi harruar që nuk kemi pasur ujë në vitin 2024. Po me vjen keq prej mysafirrit këtu me përmend që nuk kemi pasur ujë në vitin 2024, që është baza e jetës. Uroj në vitin 2025 të punoni me shumë, të jeni me transparent, të ofrohen kushte për qytetarin e jo vetëm për firmat që i keni me të afërta dhe të shkojmë përpara. Jemi e vetmja komunë në Kosovë që kemi ngelur prapa me zhvillim ekonomik. Pyetja: Kur do të ketë zhvillim ekonomik? Projektet që janë nisur, kur keni me i realizuar, si çështja e urës që ka filluar 2022 e projekte tjera, kur kanë me përfunduar? Ne po duhet me ngritur çështje në KK, se për këtë punë jemi këtu. Ne si KK keni pasur mundësi me pasur një pikë të rendit të punës për këto çështje.

z. Agim Çaka: E përshëndes z. Rexhep (Recep Gündüz) nga Turqia.

Unë në bazë të takimeve me qytetarë, kam disa shqetësime të cilat do t'i ngriti këtu.

1. Dritat brenda parkut në Strazhë, nuk funksionojnë. Kjo është për shkak të instalimit të keq që është bërë atje.

2. Trotuari, anësorët nëpër pisha, është projekt i dështuar.

3. Projekti i shkallëve të Guri i Shpum, nuk e di a keni shkuar atje me pa, puna nuk është bërë mirë dhe ka shumë gjasa që projekti me qenë i dështuar.

4. Shenja në rrugën” Komandant Bardhi” në Kaçanik të Vjetër, që 2 vite është e rrëzuar, nuk besoj se është punë e madhe me u rregulluar, kjo është pakujdesi dhe pa përgjegjësi shumë e madhe.

5. Në rrugën magjistrale, me duket para 1 muaji ka ndodhur një fatkeqësi, për shkak të mungesës së anësorëve. Me herët ka pasur një veturë, me pasojë të vdekjes, pastaj ishte ky rasti i fundit ku humbi jetën 1 vajzë në aksident tragjik. Kjo gjendje e rrugës po qëndron ende ashtu, si pasojë qoftë e pushtetit lokal apo e atij qendror. Kur do të merren masa që këto probleme të evitohen?

z. Rustem Zenuni: I uroj mirëseardhje z. Rexhep (Recep Gündüz) që ka gjetur kohë dhe mund për me ardhur sot këtu. Uroj që Kaçanikun të shoh dhe njoh edhe me shumë, e jo vetëm prej kësaj seance. Nuk kam ndonjë pyetje, vetëm desha me përshëndetur mysafirin.

z. Agim Mani: E falënderoj z. Rexhep (Recep Gündüz) që ka gjetur kohë të lirë për me qenë pjesë e kësaj seance. Përshëndes edhe drejtorin e SHMP.

E kam një pyetje apo shqetësim: Cila ka qenë arsyeja që komuna jonë nuk ka aplikuar për projekte të banimit social, e që qeveria ka ndarë 37 milion euro për këtë projekt? MMPHI tashmë ka nënshkruar një bashkëpunim mirëkuptimi për këtë projekt të banimit social, ku komuna jonë nuk ka aplikuar dhe nuk ka arritur të shfrytëzojë këtë mundësi. Nga 27 komuna që kanë shprehur interes, komuna jonë nuk ka shprehur interesim për këtë projekt shumë të rëndësishëm.

znj. Kadrije Lika-Troni: E përshëndes mysafirin z. Rexhep (Recep Gündüz) që e ka respektuar KK me pjesëmarrjen e tij.

Shprehni një shqetësim për drejtorin e DSHMS, është hera tretë që kërkoj që në planifikim të drejtorisë të jetë një psikolog në QKMF, ndërsa nuk me ka kthyer përgjigje. Në anën tjetër, përgjigja e drejtorit të Arsimit është në kundërshtim me atë që ka thënë në Komitetin për Politikë dhe Financa Kam kërkesë për dy drejtoritë, me i shqyrtuar mundësitë e kërkesës time me planifikim të vitit 2025 për një psikolog në QKMF dhe një asistent për fëmijë me nevoja të veçanta në SHM ”Skënderbeu” se janë shumë të nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

2. Propozim Vendim për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut;

Komuna jonë ka pasur një vendim dhe një marrëveshje me BI për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore. Tani Propozim Vendimi është edhe për pagesën e hapjes së varrit, se kjo çështje është bërë problem për shumë komunitete dhe qytetarë, në rastin kur kanë me së shumti nevojë. Kostoja është rritur, se janë rritur edhe shërbimet nga koha kur është marrë vendimi, qoftë e derivateve, drurit etj. E hapi diskutimin:

z. Rustem Zenuni: Me vjen mirë që komuna ka pasur mundësi me iu përgjigjur kërkesës së Bashkësisë Islame-BI, kur dihet se shqetësim i tyre dhe i vet qytetarëve ka qenë, hapja e varrit, se po ballafaqohemi me këtë problematikë. Ne si grup i PDK i kemi përcjellë në vazhdimësi këto shqetësime dhe besoj se kemi arritur bashkërisht që këtij problemi t’i japim vërdiktin. Uroj që komuna e Kaçanikut në vazhdimësi jo vetëm kësaj çështje, por edhe çështjeve tjera t’iu vjen në ndihmë me iu bërë zgjidhje qytetarëve të komunës.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ky vendim është i qëlluar, për me ua ndihmuar sadopak qytetarëve të komunës, sidomos në ditën të dhimbjeve që i kanë. Shtesat që janë shtuar janë të

mirëseardhura, ndërkaq të pika 8, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, është bërë gabim teknik, thuhet shfuqizohet vendimi 2029, gabim ky i përsëritur dy herë të kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit: Gabimi teknik do të korrigjohet në vendim.

znj. Ardita Rrahmani: Kjo çështje është diskutuar gjerë e gjatë edhe në KPF. Në KPF u diskutuar për një pikë për përkrahjen e personave të tjerë. Qysh është mënyra e subvencionimit për raste të tilla mortore, çka ka ndodhë kundrejt kësaj, si do të veprohet?

Kryesuesi i Kuvendit: Në KPF ne e ngritëm si çështje, sepse ky Propozim Vendim ka të bëjë me shpenzimet e varrimit të personave të fesë islame. Pasi jemi duke folur për vendime të ligjshme të komunës, atëherë në vendimet tona duhet bazohemi në ligjet e Kosovës dhe Kushtetutën e Kosovës, të cilat i njohin edhe bashkësitë tjera fetare. Edhe pse në komunën tonë nuk ka, ky është një vendim që mbetet në arkiv, dhe duhet me iu shërbyer të gjithëve. Për atë duhet futur një nen që për përkatësitë tjera fetare, kjo shumë, t'iu ndahet familjeve. Për fenë islame, paguhen të gjitha shërbimet, por për fetë tjera, u d akorduam edhe në KPF që për mos me na u kthyer vendimi, të parashihet një nen për konfeksionet tjera fetare, shuma 300€ t'iu ndahet familjeve për kryerjen e shërbimeve për rivalet e tyre.

z. Naim Beça: Këto shërbime a janë vetëm për qytetarët e komunës së Kaçanikut? Këtë po e theksoj sepse ka raste të vdekjeve në Turqi, ata nuk kanë dokumente të komunës së Kaçanikut, ndërkaq familja donë me varrosur këtu të vdekurin. Rastet të tilla kemi pasur shumë edhe prej Maqedonisë së Veriut etj.

Kryesuesi i Kuvendit: Në Propozim Vendim thuhet, për të gjitha rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut. Këtu bëjnë pjesë qytetarët që jetojnë brenda komunës së Kaçanikut. Për ato rastet tjera, nuk besoj se merr obligim drejtoria, nuk besoj se ky vendim i përshinë qytetarët jashtë komunës së Kaçanikut. Pika 1, është e qartë, se është fjala për banorët rezidentë të komunës së Kaçanikut. Ne kemi shumë banorë që jetojnë në komunat tjera, por ata që janë regjistruar në komunën e Kaçanikut, për ata ka të bëjë ky vendim, për ata që nuk janë të regjistruar banorë të kësaj komune, ky vendim nuk vlen.

z. Naim Beça: Sa i përket këtyre të feve tjera, ata nuk kanë vend ku me u varrosur, duhet me pasur një vend të veçantë, se ata nuk munden me u varrosur të varrezat e fesë islame.

z. Ramadush Osmani: Bazuar në takimin e KPF, u ngritën shqetësime për shpenzimin e varrimit për rastet mortore të feve tjera. Për mos me dërguar edhe njëherë Propozim Vendimin me ndryshime, Zyrës së KK ia kam dërguar të plotësuar me një nen të ri, është zhvendosur një nen dhe futur një nen të ri, për rastet e mbulimit të shpenzimeve në vlerën e njëjtë për fetë tjera. Për rastet e fesë islame, pas vendimit, lidhet marrëveshja me Bashkësinë Islame. BI e merr obligim me i kryer shërbimet e varrimit. Në konsultim me DBF, shtimi i një pike në vendim, teksti do të jetë kështu: “Me rastin e aprovimit të këtij vendimi, konform rregullave ligjore të shpenzimit të parasë publike, do të ekzekutohen mjetet si në pikën 1 dhe 3 për çdo rast mortor të paraqitur të qytetarët e komunës së Kaçanikut, pa dallim të përkatësisë fetare. Kjo i mbulon të gjitha rastet, pastaj si të aprovohet vendimi, për rastet e fesë islame, lidhet marrëveshje, ndërkaq për rastet e feve tjera, ia procedojmë mjetet direkt familjes.

Kryesuesi i Kuvendit: Me këtë ndryshim që e potencoj drejtori: “Me rastin e aprovimit të këtij vendimi, konform rregullave ligjore të shpenzimit të parasë publike, do të ekzekutohen mjetet si në pikën 1 dhe 3 për çdo rast mortor të paraqitur të qytetarët e komunës së Kaçanikut, pa dallim të përkatësisë fetare” e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 27. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për financimin e shpenzimeve të varrimit, për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 060/01-30804/24.

3. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;

Kryesuesi i Kuvendit: Është lista e përgjithshme dhe lista e veçantë e pronave të komunës, e cila është në obligim ligjor që në çdo fund të vitit të aprovohet lista e pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin vijues. Komuna duhet t'i këtë të publikuar të gjitha pronat komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim, varësisht nga shprehja e interesit të biznesit apo individit. E hapi diskutimin;

z. Bashkim Luma: E përshëndes mysafirin z. Rexhep (Recep Gündüz) që na është bashkangjitur në këtë seancë.

Të kjo pikë e rendit të punës, dua të ritheksoj qëndrimi tonë si LVV, meqë nuk po respektohet neni 13 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme. Neni 13 pika 2 thotë: “Të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës”. Nëse krahasojmë listën të cilën e kemi nxjerrë me të dhënat e saj dhe me këtë nen të këtij ligji, shohim se këto të dhëna nuk janë të përfshira, përveç të dhënave kadastrale të pronës. Prandaj, ne si LVV jemi kundër shkeljes së ligjit, përpos kësaj, kërkojmë të bëhet përmirësim në këto lista që vazhdimisht po na sjellën në KK, duke ia shtuar qëllimin, destinimit, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është listë, e cila përfshinë numrin e përgjithshëm të pronave në territorin e komunës së Kaçanikut. Nuk është kjo listë që jepen pronat në shfrytëzim me vendim paraprak, se ai vendim vjen përsëri në KK pa ofertues, që duhet të përmbajë, qëllimin, kohën, pastaj formohet komisioni për me i udhëhequr procedurat për ato prona, pastaj vjen rekomandimi në KK për miratim. Pas vendimit të KK nënshkruhet kontrata me ofertuesin që iu ka dhënë prona në shfrytëzim. Këto lista komuna është e obliguar me i publikuar në faqe të komunës, në sipërfaqe me numrat kadastrale dhe ku gjenden.

z. Bashkim Luma: Ne ligj janë neni 13 dhe 14 që e përcaktojnë këtë çështje. Neni 13 përcakton publikimin e listës së pronave, pastaj janë pikat tjera 1 dhe 2 ku përmenden këto që i përmenda me herët. Kurse të Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, përmenden ato që i përmendet ju kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit: E njëjta është Bashkim.

z. Agim Mani: Bashkimi i përmendi ato që kisha me i thënë, shqetësimi ynë është i kahershëm që i keni sjell ju në këtë formë, ju po bini në kundërshtim me vetveten. Jeni bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, neni 13, paragrafi 1 dhe 2. Në paragrafin 2 shënohet: qëllimi, destinimi, afati kohor. Ju po thirrni në 2 paragrafë të neni 13, ndërkaq nuk po e respektoni. A jeni kundër këtij paragrafi, nëse jeni kundër, atëherë mos u thirrni sipas tij. Ju na i keni ofruar 2 lista, lista e përgjithshme e pronave komunale dhe lista e veçantë për pronat që do të jepen në shfrytëzim në vitin 2025. Sidomos lista e veçantë duhet t'i përmbajë këto që u përmenden në paragrafin 2 të neni 13.

Kryesuesi i Kuvendit: Të njëjtën listë dhe të njëjtën formë është miratuar në vitin e kaluar lista e pronave të paluajtshme komunale, të njëjtin qëllim dhe të njëjtin arsyetim, ligjshmëria është shqyrtuar dhe nuk ka pasur ndonjë problem. Ato që u përmenden, pasojnë pas këtij vendimi që ekzekutivi donë me i dhënë në bazë të vendimeve paraprake dhe qëllimin e caktuar.

znj. Ardita Rrahmani: Si LDK, në parim e miratojmë dhe e votojmë, e kemi bërë edhe herëve tjera, për të zhblllokuar ose për të kryer një obligim ligjor që e përcakton ligji e që e ka obligim edhe Kuvendi i Komunës. Shpresoj se në vitin 2025 mos të ndodhë që për qëllime krejt politike,

individët që aplikojnë të mos munden me marrë lejen, krejt për qëllime puro politike. Ju e dini shumë mirë, sa çështje kanë qenë në KK për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, pastaj i keni kthyer me i rregulluar edhe një herë dhe asnjëherë më nuk kanë ardhur në KK.

z. Agim Çaka: Siç e theksuat edhe ju me herët, lista e pronave të komunës është votuar si listë në total. Unë nuk e kam të qartë pse duhet një listë e veçantë me u debatuar, nëse në listën e veçantë përfshihen edhe pronat të cilat i kemi votuar me herët. Nëse është në fuqi një vendim që e kemi aprovuar me herët dhe këto prona janë në atë vendim, nuk e di cila është arsyeja me u marrë ky vendim? Kush e harton listën e veçantë dhe cili është qëllimi? Prona si pronë është e njëjtë dhe në momentin e caktuar kur shtohet një pronë e cila nuk ka qenë në listë, atëherë në rregull, por nuk e kam të qartë nëse nuk ka prona të reja që i shtohen listës.

Kryesuesi i Kuvendit: Lista e përgjithshme është lista e krejt pronave që i ka komuna e Kaçanikut, ku hynë edhe oborri i komunës, oborret e shkollave e kështu me radhë. Lista e veçantë është lista që komuna jep pëlqim për me u dhënë në shfrytëzim, për atë quhet listë e veçantë. Me ligj është e caktuar që lista e veçantë duhet me u bërë për çdo vjet. Lista aprovohet dhe publikohet në çdo fund vit.

z. Agim Mani: Të lista e përgjithshme, a ka parcela që epen në shfrytëzim, nëse nuk janë në listën e veçantë?

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse pronat komunale nuk janë në listën e veçantë, nuk besoj se mund të jepen në shfrytëzim. Të titulli i materialit, është e përcaktuar lista e pronave komunale të nxjerrë nga lista e përgjithshme të cilat jepen në shfrytëzim në vitin 2025.

z. Qamil Stagova: E përshëndes mysafirin e nderuar nga Turqia, z. Rexhep (Recep Gündüz).

Në listën e veçantë janë pronat e përcaktuara potencialisht për me u dhënë në shfrytëzim. Lista e përgjithshme përfshinë edhe pronat të cilat i kemi dhënë me herët, për atë janë të shënuara që janë dhënë në shfrytëzim për afatin e caktuar. Në këtë listë janë të gjitha pronat komunale që i ka komuna.

z. Agim Çaka: Të qartësojmë, fjala vjen Kaçaniku i ka 100 prona komunale, deri tani janë dhënë 10 prona në shfrytëzim, kanë ngelur edhe 90 prona. Ne po e dimë që pronat që janë dhënë në shfrytëzim nuk janë në listë. Neve po na intereson: Pse vetëm 20 prona janë përcaktuar në listë për me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2025, se mund të jepen edhe prona tjera sipas vendimit paraprak në fuqi dhe prona tjera që janë në listën e përgjithshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Pronat e përcaktuara në listën e veçantë me u dhënë në shfrytëzim, janë edhe në listën e përgjithshme të pronave komunale. Çdo pronë që është jashtë listës së veçantë, nuk mund të jepet në shfrytëzim në vitin 2025.

z. Agim Çaka: Unë jam duke e kuptuar, por kjo formë nuk është e drejtë. Ne fillim ne kemi thënë se krejt këto pronat komunale mund të jepen në shfrytëzim të qytetarëve të komunës. Ne e kemi votuar listën e pronave komunale, ndërkaq nga lista e përgjithshme ka dalë që vetëm një pjesë e pronave mund të jepen në shfrytëzim në vitin 2025. Tani po shihet se pronat që nuk janë në listën e veçantë, nuk janë në dispozicion të qytetarëve për me u dhënë në shfrytëzim.

z. Qamil Stagova: Nëse ky KK e parasheh që një pronë me u dhënë në shfrytëzim, mundet në këtë mbledhje me propozua.

z. Selajdin Troni: Përshëndetje për z. Rexhep (Recep Gündüz).

Desha me pyetur drejtorin, pronat që janë dhënë në shfrytëzim pse nuk po mundeni me i larguar nga lista e përgjithshme? Nëse dikush i ka marrë ato prona në shfrytëzim, a janë përsëri të përfshira në listën e përgjithshme?

Kryesuesi i Kuvendit: Pronat që janë dhënë në shfrytëzim, janë në listën e përgjithshme, se ato vazhdojnë me mbetur prona të komunës, se nuk iu ndërrohet pronari dhe ato prona kanë me figuruar gjithherë në listën e pronave të përgjithshme të komunës, ndërkaq nuk janë të gjitha edhe në listën e veçantë të pronave komunale, se lista e veçantë i përmban vetëm ato prona që epën në shfrytëzim në vitin 2025.

z. Betim Shala: Përshëndes z. Rexhep (Recep Gündüz).

Me ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të lista e veçantë e planifikuar e pronave komunale me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2025, pika e parë, ato prona duhet të jenë në përputhje me PZHK. Kam një pyetje lidhur me këtë çështje: Nga pronat e planifikuara në listën e veçantë me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2025, a janë me PZHK ndonjëra prej tyre si prona industriale, se nëse nuk janë zona industriale nuk mundet me u zhvilluar si procedurë? PZHK i vjetri është në fuqi, për derisa të hynë në fuqi PZHK i ri.

Kryesuesi i Kuvendit: Me PZHK, ne e dimë që edhe pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim, deri tani, ka pasur raste që nuk kanë qenë në harmoni me PZHK, por me vendim të veçantë, iu ka ndërruar destinimi. Nuk do të thotë se vetëm pronat që janë zonë industriale, me u dhënë në shfrytëzim, se mundet me pasur edhe kërkesa tjera, siç ishte rasti i pronës në Ivajë, për zhvillim të bujqësisë. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim, nuk është e caktuar ekskluzivisht në lëmi të prodhimit, ndërkaq ne i kemi dhënë prioritet industrisë së prodhimit, ndërkaq ligji nuk e specifikon ekskluzivisht se për cilën lëmi duhet me dhënë pronën në shfrytëzim.

z. Betim Shala: Ligji thotë se pronat komunale që jepen në shfrytëzim, duhet me qenë në përputhje me planin hapësinor.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse aplikon dikush për bujqësi, atëherë kur të vjen puna me ia dhënë pronën dikujt, duhet me pasur kujdes, a është në rregull me planin hapësinor, ndërkaq si pikë kështu, nuk besoj se ka ndonjë problem, se nuk e kemi të destinuar pronën se për çka është duke kërkuar dikush. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për 18 votë, Kundër ishin 7 anëtarë nga LVV, Abstenuan 2 anëtarë: Raif Kasa dhe Agim Çaka. Prezentë: 27. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025/Lënda: 01Nr. 060/01-31287/24.

4. Propozim Vendimi për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse Siç e dini ju me iniciativën e z. Rexhep (Recep Gündüz) nga Turqia, i cili na ka ftuar paraprakisht me i vizituar komunat e Bursës, të Osman Gazi dhe të Iznikut dhe jemi pajtuar me komunën e Iznikut që t'i nisim iniciativat për bashkëpunim ndër komunal, me qëllim të binjakëzimit të komunave. I dinë aktivitetet, kryetari, drejtorët dhe çdo kush tjetër që ka qenë në vizitën zyrtare. Unë e kam njoftuar z. Rexhep për mbledhjen ku do të shqyrtohej iniciativa në fjalë, ka pasur dëshirë të jetë në këtë seancë, pavarësisht moshës, z. Rexhep ka shumë vullnet me vrapuar e me kontribuar në qytetin e Bursës. Para se me hapur diskutimin, fjalën ia jap kryetarit të komunës, Besim Ilazi, i cili ka qenë pjesë e agjendave tona.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, e përshëndeti fillimisht z. Rexhep (Recep Gündüz) i cili është sot prezentë me ne në këtë mbledhje të KK. Të njëjtën kohë e falënderoj për punën, përkushtimin dhe për sjelljet me neve gjatë kohës sa ishim në Turqi. Pasi jemi në fund vit, i falënderoj edhe anëtarët e KK për punën dhe kontributin në KK, iu uroj festën e fund vitit, iu uroj shëndet, harmoni në familjet e juaja,

me shpresën që viti i ardhshëm të jetë vit i sukseseve të përbashkëta, të jetë vit me i mirë se ky që e kaluam. Sa i përket Nismës për bashkëpunim me komunën e Iznikut, e tha edhe kryesuesi, ne kemi qenë se bashku në vizitën zyrtare, duke iu falënderuar z. Rexhep, i cili na ka mundësuar të jemi pjesë e asaj vizite. Në bashkëpunim me z. Rexhep, kemi arritur në pikën për iniciativën e nisur për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Iznikut e cila do të aprovohet sot, se ka komuna të cilat janë me shumë popullsi shqiptare që jetojnë që një kohë të gjatë atje. Prandaj, duke e pa përkushtimin e z. Rexhep këtu, bashkërisht në përcjellje edhe atje për 4 ditë, ne sot kemi arritur në këtë pikë. Nëse nuk gabojmë në pjesën e Turqisë, është aprovuar vendimi, presim edhe miratimin e vendimit nga KK të komunës tonë, për fillimin e bashkëpunimit të komunës tonë-Kaçanikut me komunën e Iznikut, që është në regjionin e Bursës. E falënderoj edhe një herë z. Rexhep për punën dhe përkushtimin dhe shpresojmë se do të marrim bashkërisht miratimin e vendimit nga KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Para se me ia kaluar fjalën z. Rexhep (Recep Gündüz), meqë është prezentë këtu. Komuna e Iznik është një komunë me 33-34 mijë banorë, komunë me shumë histori që daton nga kohërat e lashta dhe është komuna që prodhon simbolin e Turqisë në botë, që janë enët prej balte. Komuna Iznik ka shumë simbolika të përbashkëta me komunën e Kaçanikut, me shumë histori, mendoj se mund të kemi një bashkëpunim të madh në fushën e arsimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik. z. Rexhep edhe pse ka shkuar herët atje si fëmijë i vogël 2-3 vjeçar, ka arritur me ruajtur gjuhën shqipe, se ne kur ishim atje, jemi kuptuar shumë mirë me të.

z. Recep Gündüz: Po ngritëm në këmbë për me fol. Ju përshëndes, Kryetar i Komunës, Kryesues i Kuvendit se bashku me anëtarët. Selam Alekim motra dhe vëllezër. Unë kam lindur në vitin 1953 në Livoç të Gjilanit, në vitin 1956 kemi shkuar në Turqi. Në vitin 1974 kam qenë në luftë në Qipro. Në vitin 1981 kam qenë në Kosovë, ishim në Shkup me dajën dhe në një kafe-çajtoje aty kam thënë: “Republikë Kosova”, atëherë mi lidhën duar me morën, folshin serbisht, nuk kuptoja asgjë, folsha shqip dhe turqisht, nuk me marrshin vesh asgjë. Allahu e bëri kështu që pas 43 vjetëve me ardhur me u bërë bashkë me juve. Nuk me ra ndërmend se Selim Bunjakun nëna ime e ka pasur të parin kushëri, drejtor i milicisë së Kamenicës, me tha thuaj se nuk e kam parë kurrë dajën. Çka me i thënë nënës e pyeta? Thuaj se nuk kam ardhur për diçka, por ma prunë një shqiptar, me pyeti çka ke bërë ti gabime? Unë i thashë se kam thënë: Republikë Kosova. Me tha, mos thuaj më Republikë Kosova. I thashë se nuk them më. Pastaj me dërguan në Kamenicë, u takova me dajën, me dhanë një dokument, 1 muaj e gjysmë ndoja atje. Në Vitin 1999 është Çliruar Kosova. Kur me jepte Shkupi dokument me mendimin se Shkupi nuk ishte vilajet i Kosovës, me vinte zor. Tani që 25 vjet jam me një të Gjilanit, ai punon me teknikë, unë me kulturë, i kemi bërë në Bursë shkollat në bashkëpunim, me tepërmi po interesohemi për shkollat teknike. Unë sa po e shoh, këtu kam shëtitur shumë pak, teknika e mban shtëpinë, teknika e mban shtetin, atyre fëmijëve çka mundemi me iu mësuar nuk është pak, se i kemi sjellë 5 grupe nga 20 fëmijë nga 3 muaj ditë kanë bërë praktikë atje në makineri. Tani ata kishin hapur punë në Gjilan dhe në Ferizaj dhe po punonin. Unë shkova në Eurometal, e pash një fëmijë që ka kryer praktikë atje të ne dhe me shikonte, e pyeta kush jeni ju, i tregova që jam Rexhepi (Recep Gündüz) dhe me u mbushën sytë lot. Fëmijëve çka do që ju mësojmë, mirë është. Faleminderit shumë, na kanë ardhur mysafirë në Bursa, kanë ndenjur shumë, me kanë “mërzitur” e keni një shtëpi kur të vini në Bursa, se ne po gëzohemi që po na vijnë vëllazëria, se si të tregojnë se jemi shqiptar nga Kosova, secili ngritët e të nderon. Ne kujt dorën nuk ia kemi shtrirë, me flamur, me ushtri me polici, faleminderit, si ti thonë shqiptar nga Kosova, ngritët në këmbë dhe na nderon. I keni pa ju edhe vet. Ky bashkëpunim me Iznikun, ata të komunës e kanë marrë vendimin, tani do të merret edhe këtu vendimi. Sot e vizitova shkollën teknike, gjimnazin e vizitova, me i sjellë disa fëmijë nëpër fabrika, se fëmija çka po shihte, po e bënte dhe ua kemi borgj për me bërë diçka për Kosovën, se nesër edhe nipi im me thotë se çka ke bërë ti për Kosovën. Faleminderit shumë, se tre detyra i kemi, me fol pak, me punuar shumë, me u ushqyer me program. Unë fola shumë!

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit shumë z. Rexhep (Recep Gündüz). Propozim Vendimin e keni, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Falënderoj z. Rexhep (Recep Gündüz) që ndau me ne, jetën tuaj me pak fjalë. Faleminderit që e përfaqësoni Kosovën në mënyrë me denjitoze, në vendin ku jetoni. U jemi shumë mirënjohës që ne e kemi një vend të ju, por edhe ju e kemi një vend të ne. I gjithë komuniteti shqiptarë atje, mundeni me ardhur në Kaçanik, sepse keni ku me ardhur. E përgëzoj marrëveshjen e cila po bëhet sot, e përgëzoj dhe me vjen mirë me në fund një vizitë studimore po jep rezultate e saja edhe në letër.

z. Rustem Zenuni: Na vjen mirë që vizita jonë në Bursa dhe Iznik ka dhënë rezultate për një bashkëpunim. Uroj ky bashkëpunim jo vetëm në këto tre pikë, por të vazhdoj e mos të ndalet asnjëherë, se ka shumë gjëra tjera që na lidhin përpos si shqiptarë.

z. Brahim Imishti: Përshëndetje për z. Rexhep (Recep Gündüz), faleminderit që keni ardhur. Vizita ishte e suksesshme jashtë mase, kjo tregon ndaj atyre skeptikëve që pak a shumë na kanë kundërshtuar, për vizita të kota, turistike etj. Kjo vizitë në Turqi, po e dëshmon se vizitat që i ka realizuar KK jashtë vendit, janë vizita që sjellin fryte për qytetarë të komunës.

z. Agim Çaka: Faleminderit z. Rexhep (Recep Gündüz) që ka gjetur kohë me ardhur në komunën tonë në këto ditë. Në bazë të asaj që na tregove, po shihet se ju jeni njeri që i kaloni sfidat. Paske shkuar edhe në Qipro në një rrezik të madh dhe aty i ke shpëtuar, se fuqia e perëndisë është e madhe, se me vullnetin e perëndisë dhe vullnetin e njerëzve të mirë që janë në Turqi dhe këtu, mendoj se bashkëpunimin tonë do ta zgjerojmë. Sikurse ne që e kemi një shtëpi atje, edhe ju tani e keni një shtëpi këtu, do të shikojmë mundësitë me i përcjellë të gjitha ato të mira që i kemi pa atje, kemi pa punë të mira, monumente të mira, jo që nuk i kemi, se ka edhe këtu monumente të mira, po që nuk i shfrytëzojmë. Është kalaja e qytetit, kemi rrugë me kalldrëm- me kubëza që për një vit i shtrojmë, në vitin tjetër prishën, ju keni me na mësuar sesi bëhet ajo njëherë e përgjithmonë. Ne do t'i marrim prej atje punët e mira, sesi shtohet një rrugë me kalldrëm, do të punojmë, do të vazhdojmë të vëllazërohemi kështu qysh jemi. Mirë se na keni ardhur, po besoj se do mundohem me ta kthyer në mënyrën me mënyrën me të mirë të mundshme. Shpresoj se do të angazhohen të gjithë këta që janë këtu prezentë, miqtë, shokët, dhe do të mundohemi për respekt të ndërsjellë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Faleminderit z. Rexhep (Recep Gündüz), që keni gjetur kohë dhe mundësi me na u bashkëngjitur në KK, faleminderit për bashkëpunimin. Kjo është një dëshmi se puna e përbashkëta, ndërtojnë ura të forta drejt suksesit. Kjo është dëshmuar gjithmonë me shqiptarët që jetojnë atje, se janë treguar gjithmonë me të suksesshmit. Këtë e ndaj edhe nga familjarët e mi, të cilët i kam të gjithë atje, dhe sukseset e tyre na i kanë dëshmuar me punë, vullnet e besim, çdo herë me zemër dhe mendje në Kosovë. Faleminderit për emocionet që na i ke dhënë sot.

z. Naim Beça: Faleminderit shumë z. Rexhep (Recep Gündüz) që keni ardhur, gjaku nuk është ujë, na tregove sot dhe na dëshmove se rrënjët e shqiptarëve janë shumë të thella. Kanë kaluar mbi 100 vjet, edhe unë kam familjarë atje që mbi 100 vite, tregoju edhe fëmijëve tuaj se gjaku nuk është ujë. Faleminderit që keni ardhur.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë/lënda: 01 Nr. 104/02-31207/24.

Pasi përfundoj kjo pikë, z. Rexhep (Recep Gündüz) kërkoj me liruar nga mbledhja, për shkak të takimeve tjera që do t'i realizoj.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne z. Rexhep (Recep Gündüz) po e lirojmë nga mbledhja, se ka një takim me drejtorin e QKMF, ndërkaq para se me dal nga mbledhja, po e realizojmë një foto të përbashkët me anëtarët e KK, ekzekutivit dhe zyrtarë tjerë.

5. Propozim Vendimi për Aprovimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini është formuar një komision për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2025. Punën kryesore e ka bërë zyrtarja e KK e cila e ka hartuar draftin, pastaj jemi takuar si komision e kemi shqyrtuar, aprovuar dhe e kemi përcjellë për miratim. Në përgjithësi në vija të trasha është një plan orientues, i njëjti mund të ndryshohet dhe plotësohet gjatë vitit. E hapi diskutimin:

z. Agim Çaka: Sa për informacion, nëse është mbledhur komisioni, unë nuk kam pasur ftesë. Mos e merrni për të keq që nuk kam marrë pjesë në atë takim.

Kryesuesi i Kuvendit: Njëjtë ka thënë edhe Agim Mani, por u vërtetua se e kam marrë ftesën. Ftesa është dërguar, kjo është çështje teknike, të është dërguar ftesa, por ndoshta nuk e keni pa. Diskutime të tjera nuk ka, Plani i punës së KK u shtrua në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Nuk ishte Raif Kasa. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025/Lënda: 01Nr. 060/01-31155/24.

6. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit;

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna siç e dini e ka një plan të integritetit, për të cilin i raportohet kryetarit dhe ministrisë. Meqë në treguesit e performancës po kërkohet me u diskutua raporti për zbatimin e planit të integritetit edhe në KK, është sjellë ky raport këtu për diskutim. Nëse ka kush diçka urdhëroni. Për me diskutua nuk u paraqit kush, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës

INFORMOHET

Me Raportin për zbatimin e Planit të Integritetit/Lënda: 01Nr. 02-104/02-31616/24.

7. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte);

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, materialin e keni marrë, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Është për me u përshëndetur që një person ofron pronën e vet për mbeturinat inerte, duke ditur se është e pamundur që rrugëve përreth dhe kudo në lokalitete, është e pamundur mos me pa mbeturina të shtëpive të vjetra të rrënuara etj. E kam diskutuar edhe në KPF, thuhet se është një marrëveshje e veçantë që do të bëhet me personin në fjalë, besoj se e keni menduar se çka do të parashihet në atë marrëveshje, nëse mundeni me na sqaruar.

z. Naim Beça: Me intereson me ditur, komisioni që ka punuar në këtë drejtim, a ka pasur ndonjë pëlqim të komunitetit të tokave që janë aty. E dyta, a do të bëhet kjo me pagesë apo si do të jetë mënyra e menaxhimit të kësaj deponie?

z. Agim Mani: Caktimi i lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte, është një nevojë shumë e rëndësishme për komunën tonë për mbrojtjen e mjedisit. Ky proces duhet të trajtohet

seriozisht me ligjin në fuqi, që mos të dështoj kjo çështje. Duke marrë parasysh se deri me tani nuk ka arritur me gjetur lokacion, funksional për këto mbeturina, ekzekutivi duhet të veproj me kujdes për të siguruar që kërkesa private të jetë në përputhje me normat ligjore dhe mjedisore. Kjo iniciativë që ka ardhur nga një qytetar i cili ka ofruar pronën e tij si opsion, duhet të trajtohet me kujdes dhe profesionalizëm. Për ne nuk mund të mjafton një vendim të nxituar të bazuar me një vizitë të komisionit në terren, pa analizuar të gjitha aspektet ligjore. Po e themi të nxituar se, kërkesa është bërë me 06.12.2024, me 12.12.2024 është formuar komisioni, ndërkaq me 13.12.2024 komisioni ka dalë në vendngjarje, pa u bazuar në legjislacionet në fuqi, me 14.12.2024 është përcjellë lënda për KPF. Hapat e parë që është dashur t'i merr komisioni, verifikimi i ligjshmërisë së kërkesës dhe dokumentacioni e bashkangjitura, analiza e ndikimit në mjedis, sigurimi i licencës përkatëse, konsultimet paraprake me komunitetin dhe pëlqimin nga komuna, lokacioni sipas planit zhvillimor hapësinor, pastaj lënda e kompletuar me ardhur në KK. Kur të kompletohen këto, atëherë e shqyrtojmë, e jo paraprakisht me ardhur në KK, e pastaj me shikuar anën procedurale, se kështu kjo na dështon. Nëse ishin marrë këta hapa paraprakisht, ishte kryer lënda dhe nuk kishte dështuar, por ju e keni sjellë me dështuar, jo me kaluar. Ky lokacion është atëherë aq i ndjeshëm dhe aq i nevojshëm për ju si ekzekutiv, atëherë pse keni prituri deri tani që 25 vite dhe asnjë iniciativë për lokacion nuk e keni marrë me e sjellë në KK për trajtim. Unë kërkoj që të rikthehet lënda, komisioni të përgatitë një dokumentacion të plotë të bazuar në ligje dhe UA dhe për këtë çështje të procedojë në formë të rregullt në KK, që në start mos të kthej MAPL vendimin. Në këtë rast, duhet ta kemi të qartë se çfarë deponie është kjo, a është deponi private, a është publiko private, si do të menaxhohet nga komuna, duhet të kemi qartësi për këtë deponi. Nëse është deponi private, për me hapur një deponi private, ne e dimë se fillimisht operatori duhet me qenë i licencuar nga organet kompetente e jo me bërë një kërkesë një qytetar dhe me na sjellë lëndën në KK. Nëse është private, në KK duhet me ardhur licenca, që të shikojmë se a është licenca për deponi apo jo. Nëse është publike deponia, duhet të lidhet një kontratë nga komuna sesi ka me menaxhuar, sa ka me ia kompensuar pronën personit, se në të ardhmen personi mundet me kërkuar kompensim që nuk mundet me i përballuar komuna, dhe ky vendim bien poshtë. Për atë duhet paraprakisht të përgatiten të gjitha këto, pastaj lënda të vjen në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket kësaj çështje, besoj se është një hap i mirë, po flas në aspektin e përgjithshëm, se anën ligjore besoj se e dinë komisioni dhe drejtorja, për trajtimin e mbeturinave inerte, se mbeturinat duhet të ndahen. Mbeturinat inerte janë lëndë të ngurta, të cilat që krijon nga demolimi i shtëpive të cilat nuk janë të rrezikshme nga kontaminimi. Pse nuk është bërë që 25 vite, tani është një kërkesë që dikush ka shprehur interes me lëshuar pronën, sigurisht se edhe pala ka një interes për mbushjen apo rrafshimin e asaj prone. Përfitimi i komunës është i madh, se ne çdo ditë shohim hedhje të mbeturinave të ngurta, ndërkaq nuk mundem me iu shqiptuar gjoba pa pasur lokacion për mbeturina, ndërsa kur të kemi lokacionin, për hedhësit e mbeturinave pa vend, mundemi me iu shqiptuar gjoba. Mirë që ka shprehur dikush interes për lokacion, nevojë është e komunës, nuk e di interesin e tij, çështjet tjera pas këtij vendimi, menaxhimi do të specifikohen në marrëveshje në mes palës dhe komunës apo taksat të cilat mbliidhen, duhet këto të vijnë përsëri në KK. Si hap i parë për lokacion, nëse nuk ka efekte anësore, është i qëlluar, sepse bëhet zgjidhje për çështjen e mbeturinave inerte që po hedhen kudo, se nuk kanë ku me i dërguar. Aspekti ligjor, besoj se DUKMM dhe komisioni e kanë trajtuar se unë nuk e di.

z. Besnik Salihu: Desha me pyetur drejtorin, me PZHK të ri, a është paraparë ndonjë lokacion për grumbullimin e mbeturinave inerte dhe lokacion për deponi për mbeturinat e përgjithshme.

z. Qamil Stagova: Me PZHK të ri, lokacion për deponi inerte nuk me kujtohet nëse ka, ndërkaq për deponi të përgjithshme kemi të propozuar. Për lokacionin e ofruar për deponi inerte, për materialet që krijohen gjatë ndërtimit dhe demolimit të objekteve, përfshirë edhe dheun për hapjen e bodrumeve, personi që ka ofruar apo firma që ka deponinë, do të bëjë marrëveshje me

komunën. Komuna ia cakton kushtet lidhur me inkasimin e mjeteve, personat që dërgojnë material aty, që do të paguajnë, për formën e menaxhimit do të arrihet marrëveshje. Ideja për lokacion kemi pasur edhe me herët, janë shikuar disa variante, por nuk kemi arritur me caktuar lokacion për këto lloj mbeturina, ndërkaq është nevojë shumë urgjente.

z. Naim Beça: A do të bëhet me pagesë apo jo deponimi i mbeturinave? Ne kur e demolojmë një shtëpi fjala vjen, i dërgojmë mbeturinat inerte në deponi, a kemi me ia paguar firmës që e mirëmban deponinë?

z. Qamil Stagova: Ne ua paguajmë transportuesve, ndërkaq transportuesit ia paguan ia paguajnë atij që e ka deponinë.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është e rregulluar me rregullore të nivelit qendror, se deponitë menaxhohen, nuk guxojnë me mbetur pa menaxhim, duhet të rrethohen, duhet të ketë forma sesi menaxhohen. Personi që merr përsipër menaxhimin, merr përgjegjësi për atë punë. Çdo kund ku ka deponi, taksat janë evidente për deponim të mbeturinave, kemi me paguar me i deponuar mbeturinave. Edhe deponitë e përgjithshme që dërgohen në Gjilan për deponim, paguhen kamionët, nuk e di a me kg. apo qysh. Deponimi i mbeturinave duhet me u paguar. Taksat nuk munden me u caktuar, pa ardhur në KK. Sa ka me qenë taksat nuk e di, por taksa do të ketë, se deponia duhet me u menaxhuar, duhet me pasur mirëmbajtje, sigurisht se ajo ka shpenzime, për atë duhet të taksohet.

z. Naim Beça: Pse nuk po shtyhet kjo çështje për një mbledhje tjetër, në mënyrë që atëherë kur të bëhen marrëveshjet, lënda me na ardhur në KK dhe e votojmë. Pse me votuar 2 herë, tani dhe kur të vijnë marrëveshjet, kur nuk e dimë se çka jemi duke votuar, nuk po e dimë çmimin e deponimit, nuk e dimë a iu konvenon apo jo qytetarëve të Kaçanikut. A ka komuna ndonjë lokacion në pronën e saj për deponim të mbeturinave?

Kryesuesi i Kuvendit: Hapi i parë është caktimi i lokacionit, çështjet tjera vijnë pas andej.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Caktimi i lokacionit për mbeturina inerte, që na ka munguar për një kohë të gjatë, është vendim i qëlluar, nëse i plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për mbeturina inerte-ngurta. A ka me pasur menaxhim dhe pagesë, normal se ka me pasur. Pyetjet që jeni duke i bërë për këto çështje, kanë me ardhur edhe një herë në KK me një marrëveshje të veçantë, nëse sot epët drita e gjelbër vetëm lokacionit. Mandej i debatojmë këto çështje për mënyrën me të mirë të mundshme në bazë të rregullores dhe ligjeve në fuqi, bëhet marrëveshja në mes të komunës dhe pronarit, pagesa duhet me u bërë se ajo duhet me u rrafshuar, se lokacioni duhet me u kthyer në gjendje të mëparshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Përveç asaj, me e rëndësishme është menaxhimi i asaj deponie, për shkak se njerëzit munden me i hedhur aty mbeturinat dhe bëhet kaos aty. Për atë duhet me pasur menaxhim, me pasur një taksë dhe me u deponuar vetëm mbeturinat inerte.

z. Naim Beça: Ne e kemi pritur që sa kohë një marrëveshje të tillë, por çka bëhet me votën tonë nëse nuk na konvenon ajo marrëveshje, se ne po e votojmë për deponi me destinacion të caktuar, por çka bëhet nëse ju nuk kuptoheni me palën? Ai duhet me ardhur me një plan konkret për mbeturinat inerte që do të hedhën aty, si për mbetjet e azbestit etj.?

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk arrihet marrëveshje, atëherë e shfuqizojmë vendimin.

znj. Kadrije Lika-Troni: Një deponi e tillë për mbeturina inerte, është e nevojshme për komunën tonë. Me intereson, a kenë pasur me herët ndonjë vend apo ide për me bërë një deponi të tillë? A mos është dashur komuna me iu bërë thirrje qytetarëve, se ndoshta ka qytetarë që kanë prona, se ndoshta edhe terreni mund të jetë më i mirë, se thuhet ajo pjesë është pjerrtësi, se nëse terreni është pjerrtësi, mund të kemi shembje të dheut? Çka nëse vendoset për këtë lokacion dhe mbushet kjo deponi për 1 vit apo 2 vite, çka tutje? Mendoj se duhet me bërë një

thirrje për qytetarët, që me paraqitur kërkesa të tilla, pastaj me bërë një analizë dhe me vazhduar tutje.

z. Besnik Salihu: Drejtori nuk ma dha përgjigjen për atë çka e pyeta. A ka përcaktuar komuna lokacion për deponimin e mbeturinave të përgjithshme, ose inerte, se është folur për lokacion në Bajnicë. Është diskutuar njëherë si ide për në Prizren, por ajo është një situatë me e madhe.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Po përgjigjem në pyetjen e Kadrijes dhe Besnikut: Nga mandati që kam ardhur, kam pasur kërkesa të qytetarëve, për nga 3-4 vite, në fund të kësaj pjese dhe është mbyllur ajo pjesë e deponie. Nuk kemi pasur të interesuar, ka pasur individ në formë direkte apo indirekte. Para nga 5 viteve kemi pasur një kërkesën për një deponi që kemi menduar se i plotëson të gjitha kriteret, ka qenë ajo koha e Bektel Enka, një hapësirë e madhe, i kemi bërë kërkesë ministrisë së infrastrukturës, por përgjigja ka qenë negative. Arsyetimin se nuk i plotëson kriteret, nuk e di bash saktë, e patëm bërë një marrëveshje me Ferizajn dhe Shtërpçen se një pjesë e territorit është me komunën e Shtërpçës, dhe jemi tërhequr. Pjesa tjetër është kjo iniciativë e pronarit këtu, që kemi menduar se është një lokacion që i përshtatet kriterëve, se është një greminë. Pjesa që po diskutohet, e diskutojmë me vonë, se kemi praktikën e komunave tjera, me një taksë që është simbolike, për mirëmbajtje, se në këtë mënyrë e mbrojmë qytetarin dhe pronarin që e mirëmban deponinë. Pjesa tjetër ka me qenë varësisht nga përgjigja që e marrim nga MAPL. A do të jetë përgjigja nga MAPL edhe unë jam skeptik në këtë drejtim, ndërkaq ne po fillojmë si iniciativë me marrë një model të përafërt me komunën e Skenderajt, atyre iu kishte kaluar në ministri, ata e kishin deponinë nga vitit 2022. Besoj se deponia ju përshtatet kushteve dhe kriterëve, shpresoj se kalon në MAPL, taksat kanë me qenë minimale për me bërë një zgjidhje të dyanshme.

z. Bashkim Luma: Kjo deponi, a e përfshinë krejt terrenin e komunës së Kaçanikut, a e keni parasysh vendbanimet që janë në largësi? Kërkesa e shumicës së anëtarëve të KK ishte për me bërë thirrje publike, se ndoshta edhe në fshatra tjera ka edhe të interesuar tjerë me i mbushur hapësirat me mbetje inerte, dhe iu ndihmohet financiarisht, se ne privatisht nuk e dimë çka kërkon komuna.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Në këtë drejtim nëse ka të interesuar, nuk ka problem, se na ndihmoni, ato janë marrëveshje interne që bëhen. Mendova që ka ndonjë rast atje që është i interesuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht deponia caktohet si e përgjithshme, ndërkaq për fshatrat që janë në largësi, mirë është me bërë zgjidhje tjetër. Kjo deponi është nevojë, se po hedhën kudo mbeturinat e ngurta, ndërsa sa herë të paraqitet nevoja për deponi shtesë, është mirë me i shqyrtuar mundësitë.

z. Bashkim Luma: Mbeturina ka kudo, është kompania që merret me këtë çështje, ndërkaq gjoba shumë pak shqiptohen për hedhje të mbeturinave në formë ilegale.

Kryesuesi i Kuvendit: Ajo është tjetër temë, ata kanë titullar, kanë përgjegjësi, mundem me ngritur si problem, se ata janë përgjegjës dhe marrin paga për atë punë. Ne nuk kemi pasur zgjidhje për mbeturinat inerte, ndërkaq për mbeturinat tjera është zgjidhja, është kompania regjionale në Ferizaj dhe kjo lokale "Pastërtia" këtu në Kaçanik, të cilët janë përgjegjës. Ne mundemi me debatuar për mos përgjegjësi në punë, përndryshe ata kanë një titullar dhe një adresë. Pa adresë kanë qenë këto mbeturina, të cilat po vendosim me i kanalizuar me një drejtim. Është mirë nëse ia arrijmë qëllimit, se njerëzit i kanë hedhur mbeturinat inerte përgjatë rrugëve, ndërkaq nuk ka pasur drejtori bazë ligjore me i gjobitur, pa pasur lokacion për to.

z. Bashkim Luma: Unë për atë e theksova, se për mbeturinat tjera, zgjidhja është, por gjobat nuk po shqiptohen nga inspektorati kur mbeturinat po hedhen në vende jo të duhura.

z. Agim Çaka: E para, po debatojmë për një kërkesë të cilën e kemi ngritur sa herë, mbeturinat inerte të hedhura përgjatë rrugëve, dhe kjo na ka penguar shumë. Problemi është se personi që e ka ofruar lokacionin, ka nevojë me mbushur atë vend, e jo pse komuna po ka nevojë. Rastet të tilla për me i mbushur lokacionet ka shumë dhe kanë paguar ata që e kanë mbushur lokacionin, kështu në këtë drejtim duhet me pasur kujdes të çështja e pagesës, se ne po duhet me paguar për me ia rrafshuar palës lokacionin. Caktimi i lokacioni për mbeturina inerte, është punë e mirë, por e shoh shqetësuese pse komuna p.sh. me gjithë këtë potencial ekzekutiv, nuk është në gjendje me gjetur një deponi në pronën e vet dhe me ditur që komuna e ka deponinë për mbetje inerte. Pastaj, iniciativat e momentit janë të mirëseardhura në momente të caktuara kushdo që paraqitet edhe pas kësaj, mendoj se duhet me ia dhënë mundësinë, veç a i plotëson kushtet, me ditur qytetarët ku me dërguar atë mbeturinë. Kushtet me qenë të specifikuara, e jo me hedhur mbeturina vend e pavend, se po paraqesin pamje të trishtuar kudo që po i shohim, është interes publik që mbeturinat mos me qëndruar rrugëve, por me u deponuar diku.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për 18 votë, Kundër ishin 6 anëtarë nga LVV. Abstenuan: Naim Beça dhe Agim Çaka. Prezentë 26. Nuk ishte Raif Kasa. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe mbeturinave të demolimit të objekteve ndërtimore (mbeturinat inerte)/ Lënda: 01Nr. 60/01-31476/24.

znj. Ardita Rrahmani: Shprehi shqetësimet e saja për kushte pune, mos ngrohja e sallës, besoj se pajtoheni secili që jeni këtu. Nuk ia kemi askujt borgj me ardhur këtu me u mërdhirë, me u ftohur, ose në të kundërtën e ndërprerjeje këtë seancë.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Ju e dini që salla sa herë ka qenë e ngrohtë, tani për shkak të kushteve, klimat janë të gjitha të lëshuara, fatkeqësisht që po kemi ndërprerje të energjisë elektrike, në këtë rast jemi duke e furnizimi është me gjenerator dhe është e pamundur me bartë gjeneratorin krejt ngarkesën. Jemi detyruar zyrtarëve me ua ndalë nxehjet apo klimat dhe me aktivizuar këtë pjesë, për arsye se nuk e bartë me tepër gjeneratori. Kërkoj falje nëse dikush po ndihet keq, me të vërtetë është ftohtë. E kemi parasysh kërkesën e juaj, por për momentin këto janë kushtet.

znj. Ardita Rrahmani: Kërkoj falje se nuk kam asgjë personale me askënd, por nuk është hera e parë që nuk ngrohet salla. Kur është kështu ftohet, ose shtyni seancat ose i mbajmë diku tjetër, gjë që na lejohet. Duhet me qenë përgjegjës dikush për shëndetin tonë. Krejt me pallto po punojmë këtu.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pse radiatorët nuk funksionojnë?

z. Naim Beça: Ju kryesues duhet me na mbrojtur neve.

Kryesuesi i Kuvendit: E shpjegoj edhe drejtoresha, ne këto kushte i kemi. Me shkuar në shtëpinë e kulturës është edhe me ftohet. Në këtë rast problemi po dihet, janë katër 4 klima që e nxehin mjaftueshëm sallën, por nuk ka rrymë. E kuptoj shqetësimin e juaj Ardita nuk është bash ashtu qysh je duke e bërë problem këtë punë, se kushte për punë ka, se sot në secilën shkollë apo në zyre, kjo temperaturë është.

8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i ka sjellë raportet aktivitetin e kompanive që i kanë marrë pronat në shfrytëzim. Nëse ka kush diçka urdhëroni:

z. Rustem Zenuni: I trajtojmë të gjitha njëkohësisht, jo një nga një.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne mund ti debatojmë një nga një apo të gjitha njëkohësisht.

z. Bashkim Luma: Për hera tjera, me na ardhur vetëm një raport për të gjitha pronat që janë dhënë në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin prej pikës 8-14, kush çka ka me diskutuar:

z. Besnik Salihu: Ne në detaje nuk i dimë për destinimin e pronave, secila është dhënë në bazë të një plani që ka aplikuar. Ideja është që kur të vinë këto çështje në KK, me na shpjeguar se cila kompani ka vepruar sipas planit që ka aplikuar, cila ka bërë shkelje, cilat shkelje i ka bërë dhe a i keni rekomanduar për ato shkelje, se ato toka kanë qenë djerrina, ne tani nuk mundemi as me ua marrë të drejtën e shfrytëzimit e as me ua lënë. Unë nuk dua me qenë pjesë e procesit të asnjë vendimi që dëmton dike padrejtësisht. Ligjërisht nuk shkojnë të përbashkëta, por se paku diskutimet me i bërë të përbashkëta. Komisioni që del dhe i vërteton, me na treguar saktë se kompanitë a kanë shkuar në bazë të planit qysh kanë aplikuar, se realisht nuk dua me marrë vendime arbitrare, se e kemi marrë vendime dikujt me ia mbyllë. Unë vijë nga sektori i biznesit dhe nuk mundemi me ngritur dorën me ia marrë dikujt të drejtën e shfrytëzimit, në anën tjetër nuk dua me u bërë pjesë e manipulimeve. Unë kam qenë pjesë e komisionit vlerësues për “Muja “OP, unë dua vetëm t’ me tregoni se a kanë shkuar sipas planit që kanë aplikuar?

znj. Ardita Rrahmani: Unë po diskutoj për pikën e fundit, Fatmir Gashi B.I. në rregull që është dhënë prej komisionit raporti, por raporti nuk është i detajuar, sikur raportet tjera.

z. Agim Mani: Unë mendoj se raportet duhet të trajtohen veç e veç, se kështu e thotë edhe ligji. Për secilin trajtim që e bëjmë, kryetari e ka obligim ligjor në çdo 6 muaj me ardhur me raportuar para KK për të arriturat për secilin operator veç e veç. Këto raporte që i keni sjellë në KK, krahasuar me herën e kaluar, ku komisioni kishte afruar një përshkrim me të detajuar, gjatë inspektimit, duke u bazuar në planet dinamike të operatorëve apo autoriteteve kontraktuese, raportet e tanishme janë tejte të mangëta. Me parë komisioni kishte paraqitur statistika të qarta të bazuar në planin e punës dhe në kontratat e nënshkruara, ishte dhënë një analizë me e plotë për realizimin e këtyre kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, përfshirë edhe rekomandimet konkrete për përmirësimin apo masat e nevojshme. Kësaj here, komisioni me tepër ka luajtur rolin e teknikut apo fotografuesit, sesa organit mbikëqyrës. Raporti që është sjellë kryesisht përmban foto të inspektimit, kanë dal në vendngjarje ka bërë foto dhe i ka sjellë në KK, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë të realizimit të kontratave. Komisioni nuk është bazuar në përmbajtjen e kontratave të nënshkruara dhe në masën e realizimit të tyre deri me tani. Këto raporte që na janë sjellë, nuk i përmbushin standardet, por ka shkelje ligjore nga kryetari i cili është i detyruar në çdo 6 muaj të informoj KK. Kësaj here janë sjell raporte shumë të mangëta, në këtë rast e kemi pikën 8, nuk ka sjellë asnjë rekomandim, asnjë zbatim të kontratës së nënshkruar në mes të kryetarit dhe operatorit. Të pika 8, “Muja “OP, ka nënshkruar kontratë me datën 19.12.2019, në afat për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës për 40 vite. Planin ishte përcaktuar me kontratë me u realizuar brenda 2-5 vite, në tre faza. Në bazë të marrëveshjes kjo kompani është dashur të fillonte punën dhe të punësonte 50 punëtorë, d.m.th. tani ishte dashur kompania të filloj punën dhe të punësoj 50 punëtorë, realisht nuk e ka kryer ende fazën e tretë. Për këtë duhet me na dhënë llogari kryetari për ngecjet e kompanisë, cilat janë rekomandimet që ia ka dhënë biznesit. Ne nuk jemi kundër biznesit, jemi me i dhënë afat ende, por ne si KK duhet me ditur ku kanë ngecur kompania, edhe sa afat kohor i duhen se duhet me ia dhënë, por ju në këtë rast i keni neglizhuar këto raporte, e keni dërguar një komision në vendngjarje i cili komision nuk ka sjellë asgjë, përpos foto. Këtu inspektimi nuk është bërë, ju e keni sjellë inspektimin e vitit 2023- raportin e vitit 2023, ndërsa për vitin 2024 janë sjellë vetëm foto, për të gjitha kompanitë njëjtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja që po thoni se duhet trajtuar një nga një, janë trajtuar një nga një, por unë kërkoja nga ju që në debat t’i trajtojmë si të përbashkëta, se ekzekutivi i ka sjellë të veçanta.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Sa i përket raportimeve, është raportuar edhe vjet edhe sivjet brenda afatit të përcaktuar kohor. Çështja që po thoni se raporti është i mangët, unë jam konsultuar me komisionin, ata me kanë thënë se raportin e kanë anëtarët e KK, ne i kemi paraqitur vetëm ndryshimet që janë pas atij raporti, se me paraqitur krejt gjendjen, materiali bëhet voluminoz 200 faqe. Ndryshimet nga 6 mujori janë edhe me foto, që edhe mua me janë dukur korrekt me i paraqitur vetëm ndryshimet, me pasur edhe me lehtë anëtarët e KK se për çka po diskutohet. Të metat, aty ku janë bërë shkelje, unë kam dhënë rekomandime në KK dhe ua kemi marrë të drejtën e shfrytëzimit dy kompanive. Me shikuar bash hollësisht, asnjë bash ka kërkuar nuk i plotësojnë, por duhet me pas mirëkuptim me i tejkaluar, se ne mundemi me i mbyllur krejt, dhe me thënë kryetari e respektoj ligjin në përpikëri, por i mbylli të gjitha bizneset. Ne njëfarë forme iu kemi dhënë mundësinë me mirëkuptim, për një zhvillim me të mirë ekonomik. Kjo ka qenë arsyeja, se po e dimë situatën që jemi, dita ditës po largohen qytetarët, shumica nuk munden me gjetur punëtorë, kanë lëvizë disa kompani duke iu bërë presion, jo në masën që duhet, por jemi duke u munduar në formën me të mirë të mundshme me iu dhënë vullnet që me mbërri aty ku synojmë, aty ku e kemi qëllimin e përbashkët, përndryshe nuk e kemi problem me iu sjellë herëve tjera raporte me shumë faqe, por materiali bëhet i shumë. Pajtohem që ka mangësi nga kompanitë, por siç e theksova, jemi duke u munduar mos me ardhur në situatën sikurse për dy kompanitë e mëhershme.

z. Agim Mani: Qëllimi im nuk është me i mbyllë bizneset, bizneset i ndihmon duke i mbikëqyrë, që mos me na ndodhë ajo që e potencove me herët. Po të ishin mbikëqyrë ato kompani me herët për realizimin e planit qysh e kanë pasur, ishin sot aktive, por nëse ju i lejoni me punuar në këtë formë pa mbikëqyrje, në fund detyrohesh me ia mbyllë biznesin, ajo është formë me e keqe. Është me mirë në start me i marrë veprimet, se komisioni kur shkon në vendngjarje, në bazë të raportit, i nxitë me punuar me shumë. Mirë është me shkuar komisioni, se ne duhet me i ruajtur bizneset duke shkuar komisioni, duke iu ndihmuar, duke i shikuar rekomandimet se çka mundemi ne me iu ndihmuar, në këtë formë i mbrojmë bizneset.

z. Bashkim Luma: Kryetari e përmendi se është problem me gjetur punëtorë bizneset, por puna e punësimit është faza e fundit e një biznesi. Problemet kyçe po ndodhin në strat, realizimi i planit dinamik, krijimin e kushteve për punë, fazat e para nuk po realizohen. Komisioni po i mbikëqyrë dhe po jep raporte në çdo 6 muaj, është dashur edhe me herët, se dhënia në shfrytëzim e pronave komunale ka ndodhë me herët 2019.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: E vërtetë Bashkim, por ka qenë kohë pandemie.

Kryesuesi i Kuvendit: Një kohë pandemia, pastaj inflacioni. Nëse keni pak kontakte me bizneset, e shihni se në çfarë gjendje janë bizneset. Raportet i kemi, janë dhënë ato që është punuar nga koha e raportimit të kaluar, ka shumë procedura burokratike, sidomos për lejet energjetike nga KEK.

z. Agim Mani: Ka prona që janë dhënë në shfrytëzim në vitin 2023 në Koxhaj, për të cilat nuk keni sjellë raporte në KK, që janë në fazën fillestare, ku brenda 2 viteve është dashur me realizuar bazamentin, ndërkaq ajo kompani vetëm dy kamion zhavorr e ka shtruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Ia kanë ndalë punën, se nuk ka pasur lejen energjetike, në bazë të informatave nga jashtë, se ai ka aplikuar, por ende nuk e ka marrë lejen e ndërtimit.

z. Agim Mani: Pavarësisht asaj, ne duhet me u informuar si KK.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nuk e thashë Agim se nuk kemi të meta ne, por çka me bërë kur që 17 muaj nuk ka marrë leje energjetike. Kompania e ka paraparë realizimin e planit, por nuk ka marrë leje energjetike. Çka me i bërë ne, a me ia ndalë punën?

z. Agim Mani: Është dashur me dërguar një komision dhe ai komision me ardhur me na informuar neve se ku është problemi. Ju po thoni se është ky problem, por ne nuk e dimë.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Kompania për konservimin e turshive, ende nuk e ka marrë lejen energjetike, ndërkaq kjo kompani me seli në Tetovë është shumë serioze, me shumë punëtores. Qysh mundesh me thënë se nuk është serioze ajo kompani. Unë po të themi se nuk është e meta vetëm në komunë, se punët janë të ndërlidhura, secili nga një pengesë, kompania nuk mundet me qenë aktive. A e formojmë një komision me qenë në terren kurdo me juve?

z. Agim Mani: Ne duhet me qenë për çdo gjë të informuar, qytetarët duhet me ditur. Ka pasur interes në të njëjtin lokacion, operatorët kanë shprehur interes me investuar edhe me shumë, por nuk ia keni dhënë.

znj. Kadrije Lika Troni: Nëse duhet me pasur një leje energjetike, ju duhet me pasur një koncept.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Nuk na pyesin hiq, kanë mbetur në asfalt që 1 vjet trafo të banimi social, tani e kanë rregulluar, i kemi dërguar shkresa.

z. Qamil Stagova: Kompania tani e ka marrë lejen, 6 muaj nga kjo kohë kalojnë shpejt, dhe iu informojmë.

z. Agim Çaka: Këto raporte i kemi diskutuar në një mbledhje të KK. Qëllimi i diskutimit të atyre raporteve ka qenë, që ne me pa dinamikën e punës së atyre ofertuesve. Ne i kemi dhënë në atë mbledhje të gjitha vërejtjet tona. Tani kur na vjen ky raport, qëllimi është se nga vërejtjet të cilat i kemi dhënë në raportet e kaluara, çka është bërë brenda kësaj periudhe. Sipas asaj që shihet, gati se të gjitha raportet kryesisht konstatimi është gati si shabllon. Thotë se kanë filluar me përmbushur zotimet, e nuk përcakton se kush sa ka punuar, nuk përcaktohet me përqindje kush sa i ka përmbushur zotimet në realizim të punëve dhe parashikimeve që i ka ofertuesi, p.sh. Një kompani ka përmbushur 20%, tjetri 50%, tjetri 70% dhe ne automatikisht e bëjmë dallimin në mes të njërit ofertues me tjetrit në përmbushje të kontratës. Bile ka raport që shënohet se ka filluar me i përmbushur, mendoj se duhet me qenë me të definuar aspekti i përmbushjes se zotimeve.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Agim, po t'i marrësh 3-4 shembuj, ajo e fabrikës ka filluar dhe shtuar numrin e punëtorëve profileve të metalit dhe ka filluar eksportin. Të X- PLAST, ka hapë rrobaqepësinë që ka pasur me i marrë 30 punëtorë, 7 punëtorë i ka për momentin. Të përpunimi i drurit, e ka rritur numrin e punëtorëve, Ky është dallimi që është lehtë i kuptueshëm, jo me përqindje, se është problem, që për ne është inkurajuese që kanë filluar me lëvizë.

z. Agim Çaka: E kemi pa punën e tyre në terren, por bash për atë e theksova me bërë dallimin se cila kompani ka përmbushur pjesërisht kontratën, sikur të kjo që ka shtruar vetëm 2 kamion zhavorr.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Kjo është tjetër Agim. Kjo kompani ende nuk i ka plotësuar kriteret me marrë lejen, se është leja energjetike etj. Për me i përmbushur, për me kërkuar pastaj lejen ndërtimore.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me raportet për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për ofertuesit ekonomik si vijon:

8. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “MUJA“ OP/Lënda: 01Nr. 104/02-31123//24;
9. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “JLG CONSTRUCTION” SHPK/Lënda: 01Nr. 104/02-31126/24;
10. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.P “X- PLAST”/Lënda: 01Nr. 104/02-31125/24;
11. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “NTP GREN PRODUCT”/Lënda: 01Nr. 104/02-31127/24;
12. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik “XHEMILE VISHI.B.I”/Lënda: 01Nr. 104/02-31121/24;
13. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik N.SH.T ”LYPETENI”/Lënda: 01Nr.-104/02-31122/24;
14. Raport i DUKMM për mbikëqyrjen e realizimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ofertuesit ekonomik Fatmir Gashi B.I./Lënda: 01Nr. 104/02-31124/24.

Në fund, Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mursel, uroj edhe një herë për festat e fund vitit, e njoftoj KK se Kryetari i Komunës ka vendosur për një drekë pune, por këtë herë dreka do të jetë bashkërisht në me të gjithë punëtorët e komunës. Me datë 27 dhjetor jeni të ftuar në drekën e punës të restorant “Beni” në ora 19:00. Jeni të mirëseardhur!

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 13:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, ndërkaq me herët ka shkuar nga mbledhja Raif Kasa.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-1154/25
Kaçanik, 15.01.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 15.01.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 15 anëtarë. Në mbledhje munguan pa arsye 12 anëtarë: Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Burim Shehu, Naim Beça, Raif Kasa, Ernesta Krasniqi, Bashkim Luma, Arta Avdiu, Besnik Salihu, Betim Shala, Arlinda Rakoci-Raka, Agim Çaka.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Ramadush Osmani-DSHPE, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës: Festim Neziraj, Makfire Malsiu.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, 15 janë prezentë, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e I (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, data 15.01.2025, me këtë:

REND PUNE

1.Kërkesa e MFPT për Rishqyrtimi i Vendimit të KK 01Nr. 060/01-28018/24 të datës 29.11.2024, për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 15. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Rendin e punës prej 1 pike.

Kalojmë në shqyrtimin e pikës:

1.Kërkesa e MFPT për Rishqyrtimi i Vendimit të KK 01Nr. 060/01-28018/24 të datës 29.11.2024, për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini edhe ju, në muajin nëntor i kemi aprovuar normat tatimore progresive sipas ligjit të ri të cilin e ka hartuar qeveria dhe e ka miratuar Kuvendi i Kosovës. Në afatin ligjor vendimi është dërguar në MAPL, ndërkaq MAPL e ka përcjellë në MEFT për shqyrtim të ligjshmërisë. Ministria nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar ligjor. Me 8 janar është kthyer përgjigje, pas 1 muaji e 8 ditë me vonesë dhe kanë kërkuar me rishqyrtuar vendimin, pasi qeveria ka vendosur me një nen të veçantë që të prolongoj mbledhjen e taksës progresive, që ato norma tatimore mos të vlejnjë për vitin 2025, por të vlejnjë për vitin 2026. Ne, lëndën e kemi proceduar për KK, pavarësisht se është jashtë afatit ligjor, se mos rishqyrtimi i vendimeve po ndikon në grantin e performancës së komunës. Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Shfrytëzoj rastin se pari t'iu uroj vitin e Ri 2025, na shkoftë mbarë të gjithëve. Do të ishte me mirë fillimisht të jep sqarime drejtori i DBF.

z. Bahri Selimi: Shumë saktë e përmendi kryesuesi, sipas ligjit të tatimit në pronë, ne kemi vepruar shumë drejtë. Me 29.11.2024 është miratuar vendimi për tatimin e normave progresive, të cilat norma i kemi ulur në minimum për të gjitha kategoritë, pronave bujqësore, rezidenciale, komerciale, përkundër që të hyrat vetjake komunale ulën. Është prolonguar nga ministria neni 35 i ligjit bazik, dhe mbi bazën e kësaj, ministria krejt me vonesë vepron për me kthyer lëndën në rishqyrtim. Vendimi është marrë me 29.11.2024, me 30.12.2024 e ka shqyrtuar ministria përkatëse dhe e ka kthyer prapa. Ndërkaq, Zyra e Kuvendit të Komunës, iu ka shkruar në email se sipas nenit 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, afati ligjor për shqyrtimin e ligjshmërisë është 15 ditëve. Ata e kanë marrë vendimin 1 muaj pas afatit ligjor dhe njoftimin e kanë dërguar 8 ditë pas marrjes së vendimit, dm.th. 1 muaj e 9 ditë. Me plotë të drejtë komuna e ka publikuar vendimin dhe vendimi ka hyrë në fuqi. Pos kësaj, ne kemi marrë një njoftim nga departamenti ligjor- Departamenti i Tatimit në Pronë, i cili është në kuadër të MEFT, ku thotë se të gjitha komunat që kanë nxjerrë vendim për caktimin e normave progresive tatimore, para datës 30 nëntor 2024, mund të nxjerrin sërish vendim për caktimin e normës tatimore, sikurse vendimi për caktimin e normave tatimore për vitin 2024. Për mos me iu ardhur fatura qytetarëve me norma të vjetra, apo me të larta, me qëllim që normat tatimore të shkojnë me 0,10% e jo qysh i kemi caktuar me vendimin e miratuar për caktimin e shkallëve tatimore progresive. Kërkoj mirëkuptim që iu thirrëm në këtë seancë, por ministria na e ka kthyer vendimin në rishqyrtim dhe ne po detyrohemi me rishqyrtuar, që faturat për vitin 2025 me ardhur qytetarëve me norma tatimore të ulëta të përcaktuara si në Propozim Vendim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 15. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025 / Lënda: 01Nr. 104/02-974/25.

Me këtë Vendim, Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 060/01-28018/24 i datës 29.11.2024 për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:17. Nga 27 anëtarë sa ka KK, prezentë në këtë mbledhje ishin 15 anëtarë të cilët qëndruan në mbledhje deri në fund. Në mbledhje munguan pa arsye 12 anëtarë të KK.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



1	Data	17.01.2025	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shiro. e
	01-104/02-1746/25			

Plani i punës së ekzekutivit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Shqyrton dhe miraton: Kuvendi i Komunës

Kaçanik, 2025

1. Misioni

“Ofrimi i mbështetjes për të gjithë qytetarët, investimet kapitale dhe shërbimet administrative të përditshme duke siguruar koordinim dhe bashkëpunim midis Ministrive, Komunës, Drejtorive, Zyrave, Shoqërisë Civile dhe Partnerëve tjerë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të Kaçanikut”.

2. Vizioni

“Përsosmëri në ofrimin e shërbimeve, përfshirjen e qytetarëve, barazinë, llogaridhënien, qëndrueshmërinë, punën në grup, transparencën, sigurinë në punë dhe respektin e ndërsjellë”.

Ekzekutivi i Komunës, duke u bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloret e punës si dhe aktet e tjera ligjore, ka hartuar Planin e Punës për vitin 2025 me qëllim të përmbushjes së synimeve dhe objektivave të parashtruara për këtë periudhë kohore. Në këtë plan janë paraparë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2025, të cilat aktivitete janë bashkërenduar në koordinim të plotë me Kryetarin e Komunës.

Ekzekutivi i komunës, aktivitetin e vet e zhvillon përmes 9 drejtorive komunale dhe njësisë e zyrave të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me zyrën e kryetarit të komunës:

- **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**
- **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**
- **Drejtoria e Arsimit**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**
- **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**
- **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës**
- **Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**
- **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**
- **Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit**

- **Zyra e Personelit**
- **Zyra e Prokurimit**
- **Zyra për Teknologji Informative**
- **Zyra për Barazi Gjinore**
- **Zyra për Komunitete dhe Kthim**
- **Zyra Ligjore**
- **Zyra e Inspektoratit**

Ekzekutivi i Komunës gjatë vitit 2024 do të fokusohet në këto aktivitete kyçe:

Vazhdim i efikasitetit dhe cilësisë në punë

Vazhdim i ushtrimit të përgjegjësiave dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e Punës.

Rregullimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore

Ngritja e cilësisë në arsim dhe shërbimeve shëndetësore

Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm

Përcjellja dhe menaxhimi i realizimit të projekteve

Përkushtim i shtuar në plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësiave nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve

Thellimi i transparencës dhe llogaridhënia

Bashkëpunim ndërkomunal

Bashkëpunim i ngushtë me nivelet qendrore

Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Bashkëpunimi me organizata joqeveritare lokale dhe qendrore

Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme si përvjetorët e betejave, Ditës së Çlirimit të Komunës, Ditës së dëshmorëve, Përvjetorit të Pavarësisë, aktivitete rinore etj.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve	
	Koha	Vendi			
Misioni i Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme është forcimi i imazhit në ofrimin e shërbimeve komunale në Qendër dhe implementimi i vazhdueshëm i inovacioneve teknologjike në shërbim të zyrtarëve publik që rritin ndjeshëm efikasitetin e tyre ndaj kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.					
1. Ofrimi i shërbimeve në Qendër.					
1.1 Ofrimi i shërbimeve efikase dhe në kohë në mënyrë të vazhdueshme.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Ngritja e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
1.2 Informimi i drejtë dhe i saktë si dhe aplikimi i shërbimit “One Stop Shop”	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbim efikas dhe ulje e vonesave nëpër sportele të palëve	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
2. Ngritja e efikasitetit në Qendër.					
2.1 Adresimi me kohë i të gjitha kërkesave që i'u drejtohen Administratës Komunale dhe Kuvendit Komunal.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Sistemimi i të gjitha kërkesave nga qytetarët, procedimi në drejtoritë përkatëse, shqyrtimi i tyre dhe dhënia e përgjigjeve palëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	

2.2 Sjellja e mirë ndaj palëve, dhënia e udhëzimeve dhe informimi i tyre.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Rritje e besueshmërisë të qytetarët.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
2.3 Përdorimi i sistemit të pritjes dhe menaxhimin e radhës në sportele	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Eliminimi i pritjeve të gjata për shërbime komunale.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
3. Bashkëpunimin dhe organizimin e punës në Gjendjen Civile					
3.1 Përcjelljen e punës dhe të aktivitetëve të të gjithë zyrtarëve të Gjendjes Civile	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të vendit.	Punë më efektive dhe rezultate edhe më të mira, duke respektuar ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
3.2 Bashkëpunim shumë të ngushtë me ministrinë përkatëse siç janë: MPB, MAP, MAPL si dhe departamenteve që operojnë në këto ministri.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Bashkëpunim të mirë me ministrinë për mendura e sidomos me MAPL konkretisht me departamentin e TI lidhur me përmirësimin e programimeve në Gjendjen Civile.	MPB, MAP, MAPL	
3.3 Raportimi i të gjithë punës së Gjendjes Civile në Komunën e Kaçanikut.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Raportet do të jenë të rregullta dhe të sakta që pasqyrojnë punën reale të këtij shërbimi.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe MPB.	
4. Përcjellja dhe zbatimi i ligjeve në fuqi dhe ligjeve të reja					
4.1 Aplikimi i të gjitha dispozitave ligjore që dalin nga Kuvendi i Kosovës.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Do të zbatohet të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe MPB.	

4.2 Vizita më të shpeshta në teren në Zyrat e Gjendjes Civile.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Koordinimi të jetë më i mirë dhe zbatimi i dispozitave ligjore të jetë më i lehtë.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
4.3 Përcjellja e të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve të reja zyrtarëve të Gjendjes Civile.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Përcjellja e njoftimeve dhe informatave tek zyrtarët e Gjendjes Civile do të bëhet me kohë.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
5. Zbatimi i kompetencave dhe autorizimeve					
5.1 Regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjes si dhe ruajtja e Akteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Regjistrimet e lindjeve, martesave, vdekjeve dhe të shtetësisë në sistem të Gjendjes Civile.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
5.2 Lëshuarjen e Certifikatave-dokumenteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Lëshimi i të gjitha dokumenteve që janë në mandat dhe në kompetencë në afat sa më shkurtë dhe me fleksibilitet.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
5.3 Marrja e vendimeve të ndryshme.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Angazhim në marrjen e vendimeve të ndryshme lidhur me procedurat e regjistrimeve të mëvonshme përmirësimit, ndryshimet etj.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
5.4 Mirëmbajtjen e librave bazë dhe Akteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Mirëmbajtjen e akteve të lindjeve, martesave, vdekjeve dhe shtetësisë si dhe mbylljen e tyre në fund të vitit kalendarik.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	

6. Zbatimi i programeve të reja në Gjendjen Civile				
6.1 Zbatimi i sistemit të unifikuar të gjendjes civile.	Janar – dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Aplikimin e sistemit të unifikuar të gjendjes civile në të gjitha zyret e gjendjes civile.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, MPB.
7. Shërbime cilësore dhe efikase në punë				
7.1 Angazhim i veçantë në shtimin e efikasitetit të punës dhe furnizim me kohë me material hargjues administrativ.	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime më efikase e cilësore për qytetarët. Përkushtim i veçantë dhe shërbime efikase për bashkatdhetarët tanë.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, MPB.
7.2 Furnizim me kohë me material shpenzues.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Furnizimin me kohë me material shpenzues si: Certifikata apo me mjete të tjera të nevojshme për zyre e Gjendjes Civile.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

8. Koordinimin dhe organizimi i punës në Arkivin Komunal				
8.1 Ruajtja, mirëmbajtja dhe sistemimi i lëndëve arkivore.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Ruajtja dhe mbrojtja e lëndëve arkivore.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Arkivi i Kosovës.
8.2 Ofrimi i shërbimeve të arkivit të komunës për qytetarët si dhe arkivimi elektronik i lëndëve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Kursimi i hapësirës fizike në objekt dhe qasje më e shpejtë, transparencë e plotë, ruajtje e sigurt e të dhënave.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

9. Bashkërendimi i punës me njësinë e përkthimit				
9.1 Përkthimi i të gjitha dokumenteve që dalin nga Komuna dhe Kuvendi i Komunës, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Plotësimi i kriterëve të Ligjit për Gjuhët Zyrtare në Administratën Komunale.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.
10. Organizimin e punës në sektorin teknik				
10.1 Mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të administratës komunale.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Nivel më i lartë i pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të administratës komunale.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.
10.2 Mirëmbajtja e oborrit të objektit si dhe largimi i mbetjeve të panevojshme nga depoja.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Pamje më e mirë nga jashtë. Lirimi i hapësirës në depo.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.
10.3 Sigurimin e gjeneratorëve.	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Mos ndërprerje e vazhdimësisë së punës si mungesë e energjisë elektrike.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.

11. Organizimin e punës në sektorin e logjistikës				
11.2 Pranimi dhe dorëzimi i gjitha faturave për të gjithë sektorët.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime, fujta në sistemin e faturimit etj.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.
11.3 Qasja në freebalance – përpunimi i faturave për të gjithë sektorët e komunës.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Punimi i gjitha lëndëve nga prokurimi.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.
11.4 Mirëmbajtja e autoparkut dhe veturave zyrtare.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime efikase dhe ulje të shpenzimeve për vetura zyrtare.	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme.

11.5 Qasja në sistemin e e -pasurisë.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime, regjistrimi dhe barkodimi i aseteve.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
12. Takimet me këshillat lokal					
12.1 Organizimi i takimeve me kryetarët e këshillave lokal .	Janar - dhjetor 2025.	Komunë. Teren.	Takime të rregullta me këshillat lokal sipas Udhëzimit Administrativ NR.02/2019 për Organizimin , Funksionimin dhe Bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme. Drejtoritë tjera.	

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

PLANIFIKIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË PUNËS SË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË KAÇANIK PËR VITIN 2025

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
I. ASISTENCA SOCIALE						
1. Përkrahja financiare familjeve në gjendje të rëndë ekonomike, të cilat i plotësojnë kriteret dhe kushtet që i parashihet Ligji i për Skemen e Ndihmave sociale me nr. 2003/15 zbatimi në përpikëri i dhe udhëzimit administrativ me nr. 08/210	Identifikim dhe përzgjedhja e familjeve të varëfura nga nënpunësit sociale në QpS Kaçanik	I përhershëm	BKK	MPMS, DMS DSHMS, QPS-së KOMUNA	Fokusimi në grupet e cenuara duke i eliminuar të gjitha familjet e papërzgjedhshme në SNS-së du ke minimizuar gjendjen e rëndë sociale dhe përmirësimin e gjendjes të familjeve në nevojë	Mungesa e ndihmave momentale
2. Monitorimi i zyrtarëve dhe shrytëzuesve të SNS-së duke i kontrolluar dhe inspektuar edhe në teren nga komisioni i autorizuar nga QPS-ja	Mbikqyrja dhe respektimi i afatit ligjor për rastet që kanë kërkuar asistencë sociale, si dhe monitorimi më i mirë i rasteve sociale	I përhershëm	BKK	Drejtori, Udh. SAS-it, nënpunësit e SAS-it dhe shërbimi administrativ	Azhuriteti më i mirë i kërkesave të palëve , respektimi i afateve ligjore	
3. Bashkëpunimi me organet lokale, komunitetin, institucionet tjera relevante , OJQ-ët lokale , ndërkombëtare si dhe donatorët e ndryshëm	Do të ketë iniciativa nga ana e jonë për takime në nivel komunal, me OJQ-ët dhe donatorët e ndryshëm me qëllim të ofrimit të ndihmave shtesë rasteve të rënda sociale	I përhershëm	BKK	Drejtori, udh. i SAS-it, institucionet relevante OJQ-ët donatorët eij.	Ofrimi i ndihmave nga të gjithë do të ndikoj në minimizimin e varfërisë së skajshme	Pjesmaria e faktorëve relevant

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
II. SHËRBIME SOCIALE	Monitorimi dhe mentorimi lidhur me zbatueshmërinë e ligjeve dhe udhëzimeve administrative.	Nuk dihet	BKK	DSHMS, DPSF Drejtori i QPS USHS Zyrtarët shërbimeve sociale	Ofrimi i shërbimeve më të avancuara konform ligjit dhe konventave ndërkombëtoare	
1. Zbatimi i të gjitha ligjeve , rregulloreve si dhe të udhëzimeve administrative, do të jetë objektiv i QPS-së						
2. Mbrojtja e fëmijëve	1 Bashkimi familjar Edhe gjatë këtij viti do të bashkimi familjar për fëmijët e braktisur, natyrisht aty ku ka mundësi , ndërsa aty ku nuk egziston mundësia do të aplikohet format tjera të mbrojtjes	I përhershëm	BKK	DSHMS, DPSF QPS-së, OJQ-ët e ndryshme etj.	Mbrojtja më e mirë e fëmijëve të braktisur	Ndikimi rrethit se dhe përkrahja e familjeve të rasteve të tilla
	2. Srehimi Familjar Rastet e fëmijëve pa përkujdesje prindërore do të strehohen tek të afërmit, ku për një numër të tyre do të sigurohen pagesa mujore prej 100 €, Po ashtu për raste e fëmijëve të braktisur dhe keqëtrajtuar do të jetë prioritet. Të gjithëve do ti sigurohen strehimin familjar për një fëmijë pagesa mujore nga prej 150 €.	I përhershëm	BKK	DPSF<DSHMS, QPS Familjet strhuese	Ofrimi i shërbimeve më të mira dhe ngrohtësia familjare për fëmijët	Familjet strehuese hezitojnë të marrin fëmijë

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	3. Birësimi (Adoptimi) QPS-ja lidhur me këtë kategori do të respektoj ligjet dhe udhëzimet në fuqi, Konventat ndërkombëtare etj. Detyrë permanente e zyrtarëve të SHS do të jetë gjetja e familjeve për birësimbrenda Kosovës, Pra vetëm atëherë kur shterren këto mundësi dhe kur do të jetë në interes të fëmijut do të bëhet adoptimi jashtë vendit me pëlqimin e Panelit të DPSF-së për adoptim.	I përhershëm	BKK	Shërbimi social DPSF Familijet adoptuese	Zgjedhja e familjes sa më të përshtatshme do të jetë motoja e jonë.	
	4. Kujdestaria Institucioni i kujdestarisë do të aplikohet konform ligjit në fuqi. Për fëmijët që për arsye të ndryshme kanë mbetur pa përkujdesje, do të bëhet përpjekje që për kujdestar të caktohen të afërmit e fëmijut.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHMS Kujdestari Ligjor etj.	Një përkujdesje më e mirë për fëmijun pa përkujdesje.	

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	5. Mbrojtja e dekuentëve të mitur Konform ligjit penal për të mitur QPS-ja do të qaset kësaj kategorie të të miturëve. Do të kemi një bashkëpunim me shërbimin sprovues.	I përhershëm	BKK	QPS, Shërbimi social, SHPK, Gjykatat	Përmirësimi i sjelljeve të të miturëve si dhe rritje e rritjeve në shoqëri	
	6. Fëmijët e rrezikuar dhe abuzuar Shërbimi social do të ketë kujdes të veçantë për këtë kategori të fëmijëve, do të ketë bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante.	I përhershëm	BKK	QPS, Shërbimi sprovues, SHPK, gjykatat, shkollat etj.	Rritje e rritjeve në shoqëri	
	7. Mbrojtja e fëmijëve të prindërve të shkurorizuar QPS-ja si organ i kujdestarisë edhe gjatë këtij viti do ta përbush obligimin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve me të cilët prindërit e tyre në proces të shkurorizimit si dhe me ata prindër që kanë probleme bashkëshortore.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHS, SHPK, Gjykatat, Strehimoret etj.	Mbajtja e kontakteve të rregulltë të fëmijëve me prindër që janë shkurorizuar	

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	8. Mbrojtja e fëmijëve me nevojë të veçanta Identifikimi i fëmijëve me nevojë me paafësi të përhershme me pagesë 120 euro	I përhershëm	BKK	QPS, DSHS Komisioni mjekësor Qendra e shëndet mental, OJQ-ët etj.	Për kategori do të ketë rezultate të mbarështetë nga komisioni mjekësor	
	9. Mbrojtja e personave të moshuar pa përkujdesje. Edhe pse kjo kategori në komunën tonë nuk është dukuri, e shpesht shërbimi social do t'iu dal në ndihmë të gjithëve konform kritereve për strehim institucional.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHM Divizioni i institucioneve familjet etj.	Trajtimi i barabartë i kësaj kategorie	
3. Mbrojtja e të rriturëve	QPS-ja në bashkëpunim me të gjitha institucionet do t'iu ofroj ndihmë të nevojshme të gjithë rasteve që kanë nevojë për riintegrimin e tyre.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHM Divizioni i institucioneve familjet etj.	Do të ketë një përkujdesje më e mirë për këtë kategori.	
rezykshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë. 3. Mbikëqyrjen e menaxhimit dhe eksploatimit të resurseve natyrore. 4. Mbikëqyrja e punëve të guëthyesve. 5. Inspektimi i një varg veprimtarive pa njoftim të pronarit. 6. Mbikëqyrja dhe mbrojtja e ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit. 7. Bën planifikimin lokal të ambientit, masat tjera mbrojtëse ndaj zhurmës, trafikut.			2. Parandalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore gjatë eksploatimit të gurit. 3. Parandalimi i shkatërrimit ose degradimit të pyjeve, parqeve nacionale dhe monumenteve të mbrojtura të natyrës. 4. Parandalimi i keqpërdorimit dhe shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore nga operatorët që bëjnë eksploatimin e gurit;	Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve; Policia e Kosovës; Inspektorati mjedisor nga niveli qendror, Përmbaruesi, Prokuroria dhe Gjykata.	
---	--	--	--	--	--

8. Bën procesverbale dhe fletëparaqitje për shkelësit e propozon masa për dispozitave ligjore dhe eliminimin e faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ambientit.						
4. Inspektimi në lëminë e Shërbimeve Publike						
1. Inspekton vendosjen e reklamave nëpër hapësira publike;	Janar – Dhjetor 2025	Komuna	1. Parandalimi i vendosjes së reklamave pa leje paraprake komunale; 2. Të ruhet prona publike dhe intervenimet në pronë publike të bëhen vetëm me leje komunale; 3. Parapraakisht paralajmërim për lirim e hapësirës publike, më pastaj urdhëresë, shqiptimi i gjobave deri te dërgimi i lëndëve tek përmbaruesi, prokurori edhe në Gjykata.	Sektori i Inspektoratit Inspektori shërbimeve publike,	- i	
2. Inspekton dhe intervenon në raste kur dëmtohet prona komunale, si psh. prerja e asfaltit, vendosja e pengesave nëpër rrugë, dëmtimi i trotuareve, dëmtimi i shtyllave të ndriçimit publik, dëmtimi i rrjetit të kanalizimit, dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit pa leje komunale etj.			4. Parapraakisht vërejtje për largimin e karrigave dhe tavolinave nga trotuaret, për të vazhduar me ndërmarrje të veprimeve për shqiptimi të gjobave deri te dërgimi i lëndëve tek përmbaruesi dhe në gjykatë. 5. Parapraakisht paralajmërim për lirim e hapësirës publike, më pastaj urdhëresë, shqiptimi i gjobave deri te dërgimi i lëndëve	Puna ekipore e përfaqshkët e inspektorëve; Policia e Kosovës, Përmbaruesi, Prokuroria dhe Gjykata.		
3. Parandalon dhe largon shitësit ambulant që mallin e tyre e ekspozojnë nëpër hapësira publike – pa leje komunale.						

5. Parandalon dhe bwn lirim e trotuareve nga ekspozimi I karrikave dhe tavolinave tw bizneseve tw ndryshme.			tek përmbaruesi, prokurori edhe në Gjykata.		
6. Prandalon dhe bwn largimin e mallit tw ekspozuar para lokaleve afariste,					
5. Inspektimi në lëminë e tregut					
1. Kontrollimi dhe mbikëqyrja e tregut dhe të subjekteve të biznesit, nga kompetencat e lejuara me dispozitat ligjore nga kjo lëmi;	Janar – Dhjetor 2025	Komuna	1. Funksionim sa më i mirë i të gjitha lokaleve afariste të subjekteve biznesore. 2. Korrektësi dhe deklarim i drejtë i cilësisë së produkteve ushqimore si dhe çmim transparent. 3. Minimizimi deri në eliminimin e tregtisë jo formale. 4. Paisjen me pëlqimin e kushteve teknike, higjienë - sanitare të të gjithë subjekteve afariste. 5. Respektimin e Orarit të Punës ashtu si është rregulluar me ligj dhe me rregullore komunale, përfshirë bizneset afariste, kafeteritë, barnatoret farmaceutike etj.	Sektori i Inspektoratit – Inspektori i tregut, Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve; Policia e Kosovës, Përmbaruesi, Prokuroria dhe Gjykata.	
2. Kontrollon dhe mbikëqyrë funksionimin e lokaleve afariste të të gjitha subjekteve biznesore – ekonomike;					
3. Kontrollë dhe pranim i kushteve teknike dhe regjistrimet e të gjitha subjekteve afariste;					
4. Inspekton respektimin e Rregulloreve të caktuara lidhur me Licencimin e bizneseve, mbishkrimet e					

firmave, zbatimin e orareve të punës, etj.					
5. Inspektim subjektet ekonomike dhe tregjet nga aspekti i prejardhjes së mallrave, pastaj ndalon shitjen jashtë lokaleve afariste (tregëtinë joformale) dhe punë të tjera të ngjashme sipas ligjit dhe akteve të tjera komunale;					
6. Kontrollimin e mjeteve matëse (peshoreve) si dhe përputhjen e gramazhës së bukës me deklarimin e saj.					
7. Kontrollimi i tregut të gjelbërt si dhe tregut të kafshëve;					
8. Gjatë vitit 2025, planifikojmë:					
9. Të kemi plane operative për inspektime, të cilat do t'i implementojmë si ekip i inspektoratit, me kompetenca të ndara, ku sipas planeve të hartuara, do të kërkojmë bashkëpunim me policinë e Kosovës,					
10. Të kemi inspektime edhe ditëve pas orarit të rregullt të punës pra në mbrëmje dhe natën,					
11. Të kemi inspektime edhe ditëve të pushimit, varësisht nga kërkesat dhe ankesat e qytetarëve;					
12. Gjatë muajit të ramazanit të kemi inspektime pas orarit të rregullt të punës (pas iftarit);					
13. Në sezonin veror të shtojmë numrin e inspektimeve, për shkak të fluksit të madh të mërgimtarëve.					

Zyra e Prokurimit

Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteteve
Koha	Vendi		
1. RAPORTIMET			
1.1 Përgatitja e Raporteve sipas udhëzimeve të KRPP-së lidhur me Kontratat e realizuara gjatë vitit 2024	Janar-2025	Kaçanik	Rritja e Transparencës dhe llogaridhënies
1.2 Përgatitja dhe dorëzimi i Planifikimit të Prokurimit për vitin 2025			
1.3 Përgatitja dhe percjellja e lëdëve për Auditim sipas planit të paraparë nga Auditori i brenshëm dhe Zyra			

Komiteti e Auditimit 1.4 Përgatitja e Vendimeve në rast kërkesave për Rishqyrtim dhe përcjellja e Vendimeve OE. 1.5 Përgatitja dhe përfaqsimi i AK në rast të kërkesave nga OE për Rishqyrtim pranë OSHP-së.	Janar-Dhjetorë		KRPP, ZKA, OSHP dhe Njësiti kërkuar.
Janar-Dhjetorë			KRPP, ZKA, OSHP dhe Njësiti kërkuar.

2. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR FURNIZIME

2.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve për furnizime sipas kërkesave të Njësive kërkuese dhe të planit të punës të ekzekutivit të Komunës për vitin 2025, Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese, Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE pjesëmarrës në njoftimet për Kontrata,	Shkurt-Tetor 2025	Komuna	Funksionalitetin dhe efikasitetin e Administratës Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë.	Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik)
---	-------------------	--------	---	--


Njoftimi për Vendimin e AK për OE pjesëmarrës dhe KRPP.				
2. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR SHËRBIME				
2.1 Përgatitja e DT publikimi i tenderëve shërbime sipas kërkesa Njësive kërkuese dhe planit të punës të ekzekut Komunës për vitin Publikimi përmes KR Formimi i komisi vlersuese ,Plotësimi përcjellja e Form. Standa OE pjesëmarrës në njo për Kontrata. , Njoftim Vendimin e AK për pjesëmarrës dhe KRPP.	Shkurt-Tetor 2025	Komuna	Funksionalizimi i shërbimeve për Administratë Komunale Arsimit dhe Shëndetësisë.	Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik)
3. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR INVESTIMET KAPITALE				
3.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve sipas listës së miratuar ne Kuvendin e Komunës, projektet kapitale për vitin 2025	Shkurt – Shtator 2025	Komuna	Krijimi i kushteve më të mira për të gjithë banorët e komunës sonë.	Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik)

Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE pjesëmarrës në njoftimet për Kontrata. Njoftimi për Vendimin e AK për OE pjesëmarrës dhe KRPP.				
4. TRAJNIMI I STAFIT				
4.1 Trajnimet e obligueshme në fushën e Prokurimit	Qershor-Dhjetor 2025	Prishtinë	Avancimi dhe profesionalizimi i stafit.	IKAP, KRPP

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2025

Raporti i punës së KKSB –së për vitin 2024

Takimi i parë i KKSB për vitin 2024 është mbajtur më **27.02.2024** të këtij viti të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut në periudhën në mes dy takimeve**
- 3.Mundësia e organizimit të një trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënës të shkollave**
- 4.Trajtimi i qenve endacak**
- 5.Të ndryshme**

Për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Rreshteri i Stacionit të Policisë Fadil Ahmetaj i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2023.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

- 1.Të mirren masa parandaluese për format e ndryshme të dhunës nëpër shkolla**
- 2.Të bëhet një plan i trajnimeve për sigurinë nëpër shkolla**
- 3.Tolerancë 0 për bizneset që nuk respektojnë orarin e punës**
- 4.Të gjinden forma për evidentimin dhe regjistrimin e qenve endacak**

Takimi i dytë i KKSB është mbajtur më **02.05.2024** që është kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve . Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i stacionit të Policisë në Kaçanik

z. Halim Shehu i cili e cilësoi si të qetë por që shqetësuese ai paraqiti mungesën e hapsirave për parkingje si dhe menagjimin jo të mirë të pyjeve e sidomos në pjesën e Parkut Nacional.

Pikat e rendit të ditës nga ky takim ishin:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**
- 3.Vetdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet e pa shpërthyer nga lufta**
- 4.Shenjat sinjalizuese,trotuaret dhe hapsirat publike në territorin e komunës**
- 5.Të ndryshme**

Rekomandimet nga ky takim ishin:

- 1.Të hulumtohen hapsira për parkingje**
- 2.Një përkujdesje më e madhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve sidomos në pjesën e Parkut Nacional që është nën menagjim të nivelit qendrorë**
- 3.Një koordinim i mirë i institucioneve në organizimin e trajnimeve nëpër shkolla rreth temës „Rreziku nga minat dhe mjeteve të pa shpërthyer nga lufta” dhe për tema tjera vetdijësuese**
- 4.Të gjinden forma në sigurimin e kushteve më të mira për objektet institucionale që mirren me qështje të mirëqenjes sociale si dhe të sigurohen nga kompanitë e sigurimit**

Mbledhja e tretë e KKSB duke ju referuar edhe Planit të Punës për vitin 2024 është mbajtur më datë 18.06.2024 i kryesuar nga Kryetari i Komunës , me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**
- 3.Përgatitje rreth sfidave eventuale gjat sezonit verorë**
- 4.Të ndryshme**

Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Halim Shehu.

Sipas Komandantit të Policisë në këtë periudhë si më shqetësuese ai theksoi dhunën në familje dhe rritjen e rasteve të vjedhjeve e gjithashtu dënimet simbolike për dëmtuesit e pyjeve.

Rekomandimet e nxjerrura nga kjo mbledhje ishin:

- 1.Të mirren masa ndaj personave që pengojnë zyrtarët publik në kryerjen e detyrës .**
- 2.Inspektorët Komunal dhe Policia të jenë më aktiv sidomos në këtë sezonë kur ka fluks të madh të automjeteve dhe njerëzve .**
- 3.Për çfardo tubimi të hapur njoftimet të bëhen me kohë dhe të jenë konkrete .**

Mbledhja e katërt e KKSBB është mbajtur më datë 28.08.2024 i kryesuar nga Kryetari i Komunës, me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**
- 3.Informatë rreth përgatitjeve të vitit shkollorë dhe gjendja e sigurisë nëpër shkolla**
- 4.Të ndryshme**

Për gjendjen e sigurisë në komunën tonë raportoi togër Skender Neziri ku sipas tij në këtë periudhë kohore ishte e qetë dhe stabile , ndërsa Drejtori i Arsimit raportoi mbi përgatitjet që janë bërë për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor.Ai gjithashtu potencoi se janë marrë masa edhe për sigurinë nëpër shkolla.

Nga ky takim dolën këto rekomandime:

- 1.Të mirren masa ndaj atyre që keqpërdorin ujin e pijes**
- 2.Të mirren masa paraprake ndaj qdo dukurie që cenon sigurinë qytetare**
- 3.Të i bëhen kërkesa të vazhdueshme nivelit qendrorë për projekte që ndryshojnë për të mirë jetën qytetare**
- 4.Të mirren masa ndaj lokaleve hoteljere që kanë të punsuar fëmijë dhe që i ekspozojnë para pijeve alkoolike**
- 5.Të bëhet publike neglizhenca e nivelit qendrorë dhe kompanive që pa ndonjë arsytim i ndërpresin projektet e filluara**
- 6.Të gjindet një zgjidhje për mësime të shëndetsore që kanë probleme shëndetsore , gjë e cila e vështirson procesin mësimorë**

KKSB takimin e pestë të radhës e mbajti më datë 29.10.2024 të cilën e kryesoi Kryetari komunës dhe ishin këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i process verbalit nga mbledhja e kaluar .**
- 2.Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve në Komunën e Kaqanikut .**
- 3.Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje .**
- 4.Aktivitete vetëdijuese për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike .**
- 5.Formimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të KKSBB-së për vitin 2025.**
- 6.Të ndryshme**

Mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi zv.Komandanti i Stacionit të Policisë në Kacanik z.Jaser Jaha i cili e cilsoi të qetë dhe stabile , ndërsa lidhur me raportin mbi parandalimin e dhunës në familje u pajtuam që në takimin e radhës të ftohen zyrtarë nga Enti për Punë dhe Mirëqenje Sociale me një raport të detajuar lidhur me këtë qështje.

Mbi aktivitetet vetëdijuese për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike Drejtori i Arsimit theksoi se për qdo vit nëpër shkollë mbahen ligjerata në bashkëpunim me Policinë dhe FSK-në.

Në këtë takim gjithashtu u formula grupi punues për hartimin e Planit të Punës së KKSBB për vitin 2025

Rekomandimet nga kjo mbledhje ishin:

- 1.Të identifikohen vendet ku potencialisht përdoren nga abuzuesit e mjeteve narkotike .**
- 2.Të përgatitet një raport më i detajuar për qështjen e narkomanizmit .**
- 3.Të kërkohet një raport i detajuar nga Enti Social rreth dukurisë së dhunës në familje .**
- 4.Të mirren masa paraprake rreth përdorimit të mjeteve piroteknike .**
- 5.Të evindentohen vendet ku mungon qasja për personat me aftësi të kufizuara .**

Mbledhja e gjashtë dhe e fundit për vitin 2024 e KKSB u mbajtë më datë 10.12.2024 të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
- 2.Informatë rreth gjendjes së sigurisë në komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve**
- 3.Masat e ndërmarrura për përballjen me sfidat e mundshme gjat sezonit dimërorë**
- 4.Miratimi i Planit të Punës së KKSB për vitin 2025**
- 5.Raport mbi rastet e dhunës në familje për këtë vit në komunën tonë dhe masat e ndërmarrura për parandalimin e kësaj dukurie**
- 6.Të ndryshme**

Mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi zv.Komandanti i Stacionit të Policisë në Kaçanik z.Jaser Jaha i cili e cilësoi si të qetë dhe stabile.Stacioni i policisë në Kaçanik është në implementim të planit operativ për sezonin e dimrit e gjithashtu ka qenë i angazhuar në fushatën vetdijësues për parandalimin e dukurisë së dhunës në familje.

Në këtë takim për një raport më të detajuar mbi dukurinë e dhunës në familje prezent ishin edhe dy zyrtarë nga Enti për Mirëqenje Sociale të cilët raportuan për periudhën një vjeqare rreth kësaj dukurie me qrast iu përgjigjen edhe pyetjeve të cilat i parashtuan anëtarët pjesmarrës në këtë takim.

Nga kjo mbledhje u nxorën edhe rekomandime të cilat ishin:

- 1.Të mirren masa paraprake për përballjen me sfidat që mundë të i kemi gjat sezonit dimëror**
- 2.Të mirren masa ndaj atyre që përdorin mjete piroteknike para datës së përcaktuara nga organet kompetente**
- 3.Bashkëpunim më i mirë i akterëve të sigurisë në parandalimin e dhunës në familje**

Temat kryesore që janë diskutuar në takimet e KKSB në mënyrë më detajuar janë në procesverbalet të publikuara në ëeb.faqën e Komunës në folderin e sigurisë(5 procesverbalet ndërsa procesverbali i gjashtë publikohet pasi që të miratohet në mbledhjen e radhës së KKSB që planifikohet të mbahet në fund të muajit shkurt).

Të gjitha këto tema janë paraparë edhe në planin e Punës së KKSB-së për vitin 2024 por që janë diskutuar edhe për tema të aktualitetit që ndërliohen me qështjen e sigurisë.

Monitorues në këto takime ishte përfajqsuesi OSBE-së .

Kaçanik ,më _____





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KACANIKUT
OPSTINA KACANIK



1	Data	17.01.2025	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Nr. nr.	Shtator
01-104/02-1704/25				



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

INFORMATË
PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS
NË VITIN 2024

Kaçanik, Janar 2025

PËRMBAJTJA:

HYRJE

QËLLIMI

ORGANET E KOMUNËS

PËRBËRJA E KUVENDIT

SHEFAT E GRUPEVE PARLAMENTARE

KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

KOMITETET E KUVENDIT

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

NJOFTIMET PËR MBLEDHJE

AKTIVITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

RAPORTIMI I KRYETARIT NË KUVENDIN E KOMUNËS

MONITORIMI I MBLEDHJEVE

PUBLIKIMI I AKTEVE NË WEB FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

AKTET E DËRGUARA NË MAPL PËR SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE

AKTET E RISHQYRTUARA SIPAS KËRKESËS SË MAPL

AKTIVITETE TË TJERA

SEKTORI I KUVENDIT

PËRFUNDIM

SHTOJCA:

EVIDENCA E AKTEVE TË APROVUARA DHE RAPORTIMET E KRYETARIT

I. VENDIMET

II. RAPORTIMET E KRYETARIT TË KOMUNËS

Hyrje

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Komuna përmes organeve të saj është e obliguar të ushtroj kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Organet e Komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre të zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vet. Në kuadër të organeve të komunës, Kuvendi është organi më i lart vendimmarrës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Kuvendi mban mbledhjet e rregullta në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, të cilat kërkohen me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi

Kjo informatë ka për qëllim, informimin e qytetarëve, Organizatave Joqeveritare dhe grupeve tjera të interesit, funksionimin e Kuvendit të Komunës të legjislaturës shtatë (7) në aktivitetin e vitit 2024. Informata shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e Kuvendit të Komunës.

Organet e Komunës

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, janë :

1. Kuvendi i komunës; dhe
2. Kryetari i komunës.

Kuvendi i Komunës, është organi më i lartë vendimmarrës në komunë, zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët e komunës, në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale (neni 35.1).

Kryetari i Komunës, zgjidhet në zgjedhjet e drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale (neni 56.1). Konstituimi i organeve të Komunës Kaçanik është bërë me 08 dhjetor 2021. Me këtë datë është bërë edhe zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit, i cili udhëheq me mbledhjet e KK, sipas detyrës zyrtare edhe me mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF.

Përbërja e Kuvendit

Përbërja e Kuvendit të Komunës i dalë nga zgjedhjet e lokale të Republikës së Kosovës të mbajtura më 17 tetor 2021, është 27 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 5 subjekte politike me numër të mandateve: Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 12 mandate, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me 8 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 4 mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 2 mandate, Nisma për Kosovën (NISMA) me 1 mandat. Shumicën në KK e përbëjnë subjekti politik i Partisë Demokratike të Kosovës -PDK në koalicion me subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK. Sipas nenit 37.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite. 37.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtar: a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij; b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur; c) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij; d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë

vepër penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj; e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye; 12 f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të pa për zgjidhshëm. 37.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lista e 27 anëtarëve të zgjedhur të Legjislaturës së shtatë (7):

1	2	3	4
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Përkatësia politike
01.	Kemal Murseli	Kryesues i Kuvendit	PDK
02.	Brahim Imishti	anëtar	PDK
03.	Hamide Luma	anëtar	PDK
04.	Kadri Krivenjeva	anëtar	PDK
05.	Fitore Vishi Lirije Dema	anëtar “	PDK “
06.	Rrustem Zenuni	anëtar	PDK
07.	Edon Baftiu	anëtar	PDK
08.	Selajdin Troni	anëtar	PDK
09.	Fatmir Bunjaku	anëtar	PDK
10.	Bashkim Krasniqi	anëtar	PDK
11.	Florina Lika-Vishi	anëtar	PDK
12.	Lejla Muhaxheri-Çaka	anëtar	PDK
13.	Agim Mani	anëtar	LVV
14.	Kadrije Lika-Troni	anëtar	LVV
15.	Adnan Reka Burim Shehu	Anëtar “	LVV “
16.	Naim Beça	anëtar	LVV
17.	Raif Kasa	anëtar	LVV
18.	Ernesta Krasniqi	anëtar	LVV
19.	Bashkim Luma	anëtar	LVV
20.	Arta Avdiu	anëtar	LVV
21.	Ardita Rrahmani	anëtar	LDK
22.	Besnik Salihu	anëtar	LDK
23.	Betim Shala	anëtar	LDK
24.	Arlinda Rakoci-Raka	anëtar	LDK
25.	Rabije Sallahi Edona Luzha	anëtar “	AAK “
26.	Ekrem Livoreka	anëtar	AAK
27.	Agim Çaka	anëtar	NISMA

Renditja e anëtarëve si në listë, Brahim Imishti nuk është në bazë të numrit të votave të fituara, por ulësen e ka fituar në zëvendësim të Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi, i cili ka qenë bartës i listës së PDK, por për shkak të pozitës së tij të zgjedhur kryetar komune, e ka liruar pozitën për anëtar të KK. Gjatë periudhës raportuese, kjo përbërje ka pësuar ndryshime si vijon: Anëtar i me nr. 15. Adnan Reka jep dorëheqje për shkak të punësimit të tij diku tjetër, ndërkaq zëvendësohet me anëtarin Burim Shehu -LVV. Anëtarja me numër 5. Fitore Vishi, jep dorëheqje për shkak të punësimit në komunë shërbyese civile, ndërkaq zëvendësohet me Lirije Dema- PDK. Anëtarja me numër 25. Rabije Sallahi jep dorëheqje për shkak të punësimit, ndërkaq zëvendësohet me Edona Luzha -AAK.

Shefat e Grupeve Parlamentare:

1. Nga PDK, Shef i GP -Rrustem Zenuni, 12 ulëse
2. Nga LVV Shef i GP -Agim Mani, 08 ulëse
3. LDK Shef i GP - Ardita Rrahmani, 4 ulëse
4. Në emër të AAK, fjalën e merr Ekrem Livoreka, 2 ulëse
5. Në emër të NISMA, fjalën e merr Agim Çaka, 1 ulëse.

Kompetencat e Kuvendit të Komunës

Kompetencat e Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL). Sipas nenit 40.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të këtij ligji, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore. Sipas nenit 40.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: a) statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre, b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregulloreve të punës; d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor; e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji; f) zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës; g) niveli i tarifave dhe ngarkesave; h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi; i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike; j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale; k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe l) përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja për Punë të Kuvendit të Komunës (kapitulli VII dhe VIII), përcaktojnë rregullat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca të rregullta në vit respektivisht deri në 12 mbledhje me pagesë, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, anëtarët e KK kanë pagë të rregullt mujore. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut bazuar në nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për gjatë vitit 2024 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, ashtu siç janë

të planifikuara me Planin e punës së KK për vitin 2024, ndërkaq është mbajtur 1 mbledhje e jashtëzakonshme. Gjatë vitit 2024 është mbajtur një mbledhje Solemne me 11 Qershor në shënim të Ditës së Çlirimit të Komunës. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në sallën e kuvendit, kanë qenë të hapura për publikun.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, janë mbajtur në datat si në tabelë:

Kuvendi i Komunës Kaçanik		Mbledhje Rregullta	Mbledhje të Jashtëzakon.	Mbledhje Urgjente	Mbledhje Solemne
Muajt		Njëmbëdhjetë (12) Mbledhje	1 Një (1) Mbledhje	-	Një (1) Mbledhje
1.	Janar	31.01.2024	-	-	-
2.	Shkurt	29.02.2024	-	-	-
3.	Mars	29.03.2024	-	-	-
4.	Prill	29.04.2024	-	-	-
5.	Maj	31.05.2024	-	-	-
6.	Qershor	28.06.2024	-	-	11.06.2024
6.1	Korrik	03.07.2024	-	-	-
	Vazhdimi 1				
6.2	Korrik	31.07.2024	-	-	-
	Vazhdimi 2	ora 10:00			
7.	Korrik	31.07.2024 ora 11:00	-	-	-
8.	Shtator	05.09.2024	-	-	-
9.	Shtator	30.09.2024	-	-	-
10.	Tetor	30.10.2024	22.10.2024	-	-
11.	Nëntor	29.11.2024	-	-	-
12.	Dhjetor	24.12.2024	-	-	-

Gjatë periudhës raportuese, është mbajtur një mbledhje Komemorative me 05.02.2024, me rastin e vdekjes së ish anëtarit të Kuvendit të Komunës, Osman Krasniqi.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KK në mbledhjet e rregullta ka qenë kryesisht mirë, me ndonjë mungesë me arsye të ndonjë anëtar, ndërkaq për arsye të ndryshme ka pasur anëtarë që nuk kanë qëndruar në mbledhje deri në fund. Ka pasur edhe bojkotime dhe lëshime të mbledhjeve. Numri me i vogël i pjesëmarrësve në mbledhje ishte në vazhdimin e parë dhe në vazhdimin e dytë të mbledhjes së 6 të KK, 03.07.2024 dhe 31.07.2024 dhe në mbledhjen e Jashtëzakonshme të KK, të datës 22.10.2024. Mbledhjen e I (parë) të rregullt të datës 31.01.2024, e kanë bojkotuar 7 anëtarë të LVV, për shkak se është kërkuar që përgjigja në një pyetje të caktuar, të jepet nga Kryetari i komunës, e jo nga drejtoria përkatëse profesionale. Mbledhjen e III (tretë) të rregullt të datës 29.03.2024, e kanë bojkotuar 6 anëtarë të LVV, përkundër faktit që e kanë marrë listën e Investimeve kapitale, kanë kërkuar në format tjetër dhe përgjigjet në pyetje dhe kërkesa të mbledhjes së kaluar, të jepen nga Kryetari i Komunës e jo nga drejtorët e drejtorive përkatëse profesionale. Në mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të datës 28.06.2024, 7 anëtarë të LVV e bojkotuan mbledhjen në pikët: 12-15, në çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, duke u thirrur në atë se, nuk është bërë zëvendësimi i anëtarit nga LVV Adnan Reka në komision vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, i cili ka ofruar dorëheqje nga 04.04.2024 nga KK, ku i kanë pushuar pozitat e ndërlidhura në KK. Vlen të potencohet se, komisioni vlerësues ka qenë ad hoc, zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr nga KK, është bërë në KK me 29.04.2024. Lëndët për dhënë në shfrytëzim të pronave komunale kanë qenë në proces, kuorum ka pasur, komisioni ka vazhduar punën. Mbledhja e 6 e rregullt është ndërprerë në mungesë të kuorumit, pasi disa anëtarë të PDK e kanë lëshuar mbledhjen kur është vendosur me u kthyer në rivotim pikët 13 dhe 14. Vazhdimi i mbledhjes së 6, është caktuar për 03.07.2024, punimet e kësaj mbledhje kanë filluar, ndërkaq janë ndërpre në mungesë të kuorumit, pasi disa anëtarë nga PDK e kanë lëshuar mbledhjen. Kjo mbledhje i ka përfunduar punimet me 31.07.2024, filluar në ora 10, ku është shqyrtuar vetëm pika 15, ndërkaq pikët 13 dhe 14 janë shtyrë për një seancë tjetër. Mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të datës 30.09.2024, e kanë bojkotuar anëtarë nga LVV gjatë shqyrtimit të pikës së dytë në të gjitha pikat tjera të kësaj mbledhje, duke shprehur pakënaqësi në ndarjen e subvencioneve të DZHET.

Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka të formuar dy Komitete të përhershme;

1. Komiteti për Politikë dhe Financa; dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Komiteti për Politikë dhe Financa është në përbërje prej 7 anëtarëve:

1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
Rrustem Zenuni	"	"
4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabiye Sallahi	AAK	anëtar
Edona Luzha	"	"

Komiteti për Politikë dhe Financa ka pasur rol të veçantë në trajtimin dhe adresimin e çështjeve të cilat kanë qenë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje nga 12 të planifikuara, duke shqyrtuar të gjitha pikat që i ka pasur në rend dite dhe i ka përcjell për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë KPF-ja i ka kushtuar çështjeve financiare siç janë: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, çështjet financiare dhe çështje të tjera me rëndësi për komunën, raporteve financiare. Gjatë vitit 2024, ka pasur ndryshim të 2 anëtarëve, Fitore Vishi nga PDK dhe Rabiye Sallahu nga AAK, të cilat kanë dhënë dorëheqje nga KK, me çka me automatizëm iu ka pushuar pozita e anëtarit në KPF, ndërkaq janë zëvendësuar me Rustem Zenuni-PDK dhe Edona Luzha-AAK. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës.

Komiteti për Komunitete, është në përbërje, 5 anëtarë;

1. Ekrem Livoreka	AAK	Kryesues
2. Lejla Muhaxheri –Çaka	PDK	anëtar
3. Arta Avdiu	LVV	anëtar
4. Betim Shala	LDK	anëtar
5. Arben Thaqi	OJQ/ Shoqëria civile	anëtar.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje që kanë qenë të parapara me Planin e punës të së këtij komiteti. Në mbledhjet e Komitetit për Komunitete, janë shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve. Aktiviteti i këtij komiteti në formë me të gjerë do të raportohet me raport të veçantë të punës. Kur jemi të komitetet obligative të KK, kompensimi bëhet për pjesëmarrje në mbledhje edhe sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ndërkaq problem ka pasur në kompensimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete nga OJQ/ shoqëria civile Arben Thaqi, i cili nuk është kompensuar për asnjë mbledhje.

Ekzekutivi i Komunës Kaçanik

Në vitin 2024, Ekzekutivi i Komunës ka punuar me këtë përbërje:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës

Drejtorët e drejtorive komunale:

1. Dardana Tafili- Dauti- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme;
2. Sali Malsiu- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale
3. Zahir Doda- Drejtoria e Arsimit;
4. Bahri Selimi- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
5. Qamil Stagova- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
6. Ramadush Osmani- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës;
7. Suhad Dullovi- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
8. Hafize Sallahi- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
9. Pranvera Loku-Zharku- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

Ylber Bajra- Shef i kabinetit të Zyrës së Kryetarit.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, pos tjerash ka të formuar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, i cili këshill ka raportua sipas Udhëzimit Administrativ që rregullon formimin, detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilli. Kryesues i KKSB është Kryetari i Komunës Besim Ilazi, sipas detyrës zyrtare. KKSB në vitin 2024 ka mbajtur 6 mbledhje, ashtu siç e parasheh UA. Aktiviteti i KKSB në formë me të gjerë paraqitet me raport të veçantë. Gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës ka formuar komisione me mandat të caktuar dhe komisione ad hoc, si: Komisioni përzgjedhës për drejtor të institucioneve arsimore; Komisioni për hartimin e Planit të punës së KK për vitin 2025, Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, -për çdo vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, të cilat komisione kanë dhënë rekomandime për ofertat me të suksesshme sipas shpalljes publike, Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, me mandat 2 vjeçar, ashtu siç e përcakton ligji përkatës. Për me gjerë, aktiviteti i komisioneve me mandat të caktuar dhe ad hoc paraqitet me raporte të veçanta. Kur jemi të komisionet e kuvendit, sfidë mbetet mungesa e bazës ligjore për kompensimin e tyre.

Njoftimet për mbledhje

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës janë njoftuar paraprakisht me shkrim, kryesisht ashtu siç kërkohet, 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, Në njoftim është shënuar: data e mbajtjes së mbledhjes, koha e mbajtjes së mbledhjes, vendi i mbajtjes së mbledhjes, rendi i ditës për mbledhje edhe materialet e mbledhjes. Materiali i mbledhjes është dërguar në formë elektronike. Gjatë vitit 2024, janë pajisur me mjete pune- laptop edhe tre anëtarët që janë e zëvendësuar. Gjatë njoftimit dhe ndarjes së materialeve të mbledhjes, i njëjti njoftim është publikuar në ueb faqen e komunës dhe në facebookun zyrtar të komunës. Njoftimi dhe materialet gjithashtu i janë dërguar edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal (MAPL), në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Materiali i mbledhjes i është dërguar edhe Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale, Zyrës së Informimit, Zyrës së IT si dhe OSBE.

Aktiviteti i Kuvendit të Komunës

Në periudhën Janar – Dhjetor 2024, Kuvendi i Komunës ka pasur në rend pune gjithsej 125 pikë apo 20 pikë me shumë se në vitin 2023. Gjatë vitit 2024 Kuvendi i Komunës ka miratuar 68 Vendime, 57 çështje tjera: raporte, plane, informata, procesverbale. Aktet e miratuara të Kuvendit të Komunës ndikojnë në krijimin e kushteve sa më të mira të qytetarëve të komunës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim, ka marrë 2 vendime për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prona komunale për 99 vjet, dhe 1 vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, ndërkaq ka shfuqizuar 2 vendime për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale, për shkak se nuk iu kanë përmbajtur kushteve të kontratës, kanë bërë shkelje të rregullave të kontratës (fjala është për operatorin ekonomik Mevlud Zharkun dhe për operatorin ekonomik KAÇINKA L.L.C), ndërkaq 2 rekomandime të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale janë shtyrë për një mbledhje tjetër, por të njëjtat nuk janë shqyrtuar gjatë vitit 2024. KK ka aprovuar vendime të karakterit financiar (rialokim, bartje, transfere) të mjeteve buxhetore sipas propozim vendimeve të Kryetarit të

Komunës, për një shpenzim më të mirë buxhetor dhe me qëllim që mjetet buxhetore mos të ngelin në suficit buxhetor, është marr vendim për aktivizimin e pagesave në QKMF. Gjatë vitit 2024 Kuvendi i Komunës ka diskutuar Planin e punës së ekzekutivit për vitin 2024. Nga aktet tjera, KK ka aprovuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027, Vendimin për miratimin e Buxhetit për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027. Kur jemi të vendimet e karakterit financiar, KK ka marr Vendim për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët. KK ka shqyrtuar raporte financiare, raporte për aktivitetin e përgjithshëm të komunës, raporte për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, Raportet dhe Planet e Komiteteve të KK, Raporte dhe Plani i KKSB, Raporte (Informata) që lidhen me aktivitetin e shkollave për fillimin apo përfundimin e vitit shkollor, Planin e veprimit në mjedis me veprim klimatik i komunës së Kaçanikut 2025-2029, Planin komunal për transport lokal publik të udhëtarëve 2024-2028, ka caktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave inerte. Gjatë periudhës raportuese, është aprovuar Iniciativa për bashkëpunim ndër komunal me komunën Iznik të Bursa të Turqisë, ku ka marrë pjesë z. Recep Gündüz Koordinator i Qendrës Kulturore, Kosova” në Bursa, që përfaqëson Komunitetin Shqiptar në Bursa. Gjatë periudhës raportuese vlen të përmenden se për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatoj Kuvendi i Komunës në seancën e vet, paraprakisht Komiteti për Politikë dhe Financa i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq pjesa dërmuese e çështjeve kanë pasur për bazë Propozim Vendimet, Draft Planet, të propozuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorive Komunale. Aktiviteti i Kuvendit të Komunës Kaçanik mund të vlerësohet së ka qenë i mirë. Krahësuar me vitin 2023, në vitin 2024 është miratuar vetëm 1 vendim me tepër. Gjatë vitit 2025 nuk është miratuar asnjë rregullore, ndërkaq ka miratuar: Statutin e QKMF dhe Statutin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut. Gjatë periudhës raportuese nuk është lajmëruar ndonjë anëtar për konflikt të interesit të anëtarëve të KK. Sfidë në zhvillimin e aktiviteteve të KK, mbeten kushtet e punës për mbledhje të KK, për shkak të sallës jo të përshtatshme dhe mungesa e foltores. Çështja se çfarë vendimesh janë marrë, si janë votuar vendimet, për me gjerë është lista bashkëngjitur e miratimit të akteve.

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raporti i Kryetari para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare, si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale dhe shfrytëzimin e parasë publike. Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës në vitin 2024, ka marrë pjesë në 10 mbledhje të rregullta të KK, në mbledhjen e jashtëzakonshme dhe në vazhdimin e dytë të mbledhjes së 6 të KK, ku forma e raportimit financiar ka qenë me shkrim pesë (5), herë, ndërkaq në formë verbale çdo herë kur është kërkuar. Dy (2) herë është raportuar për aktivitetin e përgjithshëm të komunës, një (1) herë për menaxhimin e burimeve njerëzore, dy (2) herë herë për çështjen e sigurisë. Kryetari ka raportuar përmes shërbimeve përkatëse profesionale, 1 herë për çështjen e auditimit të brendshëm, një (1) herë për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të auditimit, tre (3) herë është raportuar për çështjen e arsimit. një (1) herë për gjendjen e furnizimit me ujë të pijes, dy (2) herë ka raportuar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale. Gjithashtu ekzekutivi i komunës është përgjigjur në

formë të shkruar disa Kërkesave dhe Pyetje të anëtarëve të KK, ndërkaq KK ka kërkuar të merr përgjigje me shkrim për çdo pyetje dhe kërkesë. Kjo është një formë më e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës. Për me gjerë, raportit ia bashkëngjisim: Listën e raportimeve të kryetarit.

Monitorimi i mbledhjeve

Aktiviteti i Kuvendit monitorohet nga strukturat ndërkombëtare - OSBE-ja e cila i përcjellë mbledhjet e KK dhe KPF nga Faruk Dermaku, ndërkaq një mbledhje të KPF e ka monitoruar edhe Arben Shehu. Nga strukturat vendore, monitorimi është bërë nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal e cila vazhdimisht përcjell punën dhe aktivitetin e Kuvendit nga distanca përmes teleprezencës nga zyrtari, Vjosa Ahmetaj. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit janë mbajtur me dyer të hapura, mirëpo interesimi i OJQ të tjera, qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit ka qenë minimal, pasi që mbledhjet transmetohen drejtpërdrejtë, formë kjo shumë e mirë për të gjithë qytetarët, OJQ dhe grupet tjera të interesit me i përcjellë punimet e kuvendit.

Publikimi i akteve në Ueb faqen zyrtare të Komunës

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës dhe shkresat tjera të lëndës, dërgohen të skanuara nga Sektori i Kuvendit, Zyrës së Informimit përkatësisht Zyrës së IT për t'i publikuar në Ueb faqen zyrtare të Komunës, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, mbledhjeve të KPF-së, të Komitetit për Komunitete si dhe procesverbalin e dëgjimit publik të organizuara nga Kryesuesi i Kuvendit përmes KPF-së lidhur me buxhetin e Komunës. Vlen të përmendet së, i gjithë aktiviteti i Kuvendit të Komunës i vitit 2024 publikohet në faqen zyrtare të komunës, me përjashtim të vendimeve që kthehen në rishqyrtim nga organi shqyrtues, ndërkaq është publikuar Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelat kadastrale 00150-0 dhe 00151-0 në zonën kadastrale Kaçanik, për shkollën në Dushkajë, pasi AKP ka kërkuar me ditur nëse ka interes komuna për atë pronë, para se me nxjerrë në shitje. Kjo mënyrë e publikimit, mundëson qasjen e qytetarëve në të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës dhe qasje më të lehtë në dokumente zyrtare. Për t'iu qasur aktiviteteve të Komunës Kaçanik duhet klikuar adresën: <https://kk.rks-gov.net/kacanik/>. Duke klikuar linkun: Kuvendi, hapen Liqet: Rregulloret, Vendimet, Procesverbalet, Buxheti, Video-incizime, Dokumente dhe aktivitete tjera të Kuvendit të Komunës sipas viteve.

Aktet e dërguar në MAPL për shqyrtimin e ligjshmërisë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara në Kuvend. Gjatë periudhës raportuese të gjitha aktet e miratuara për të cilat kërkohet shqyrtim i ligjshmërisë sipas LVL, janë dërguar Zyrës Ligjore të MAPL, përfshirë të dhënat për numrin e pjesëmarrësve për secilën pikë dhe votat që ka marrë akti. Aktet të cilat janë dërguar në MAPL sipas mbledhjeve:

Aktet e miratuara në mbledhjen së parë (1) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik të datës 31.01.2024, listuar si në tabelë nga 1- 6, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abste nim	
1.	Vendim për aprovimin e Planit vjetor të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-dhjetor 2024	18 Prezentë 18	-	-	01 Nr. 60/01-1445/24
2.	Vendim për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut	17 Prezentë 17	-	-	01Nr. 104/02-1905/24
3.	Vendim për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri	16 Prezentë 16	-	-	01Nr. 06-104/02-1938/24
4.	Vendim për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi	16 Prezentë 16	-	-	01Nr. 06-104/02-1934/24
5.	Vendim për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli	16 Prezentë 16	-	-	01Nr. 06-104/02-1940/24
6.	Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut	16 Prezentë 16	-	-	01Nr. 104/02-1953/24

Aktet e miratuara në mbledhjen së dytë (2) të rregullt e Kuvendit të Komunës së Kaçanik të datës 29.02.2024, listuar si në tabelë nga 1- 8, përfshirë edhe votat që ka marrë secili akt.

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abste nim	
1.	Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite	14 Prezentë 20	-	6	01Nr. 350/01-4450/24
2.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme të komunës	21 Prezentë 21	-	-	01Nr. 104/02-4452/24
3.	Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite	12 Prezentë 19	-	7	01Nr. 104/02-4455/24
4.	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës	19 Prezentë 19	-	-	01Nr. 104/02-4453/24
5.	Vendim për anulimin e vendimit për miratim në parim të vendimit 01nr. 06-104/02-1940/24 i datës 31.01.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mejdi (Shabi) Xhokli	21 Prezentë 21	-	-	01Nr. 104/02-4712/24
6.	Vendim për anulimin e vendimit për miratim në parim të vendimit 01nr. 06-104/02-1934/24 i datës 31.01.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Adnan (Feriz) Vishi	21 Prezentë 21	-	-	01Nr. 104/02-4717/24

7.	Vendim për anulimin e vendimit për miratim në parim të vendimit 01nr. 06-104/02-1938/24 i datës 31.01.2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik Ramiz (Afiz) Shaqiri	21 Prezentë 21	-	-	01Nr. 104/02-4722/24
